# MASTERARBEIT/ MASTER'S THESIS

Titel der Masterarbeit/ Title of the Master's Thesis

„Imazhi i Bill Clinton-it dhe Georg W. Bush-it në shoqërinë shqiptare në qytetin e Gjilanit-Kosovë në vitin 2012"

verfasst von / submitted by

**Burim Bislimi**

angestrebter akademischer Grad/ in partial fulfilment of the requirements for the degree of

**Master of Arts (MA)**

Wien, 2016

| | |
|---|---|
| Studienkennzahl lt. Studienblatt/<br>degree programme code as it appears on<br>the student record sheet | A 066 687 |
| Studienrichtung lt. Studienblatt/<br>degree programme as it appears on<br>he student record sheet: | Historisch-Kulturwissenschaftliche Fakultät<br>Master Studium<br>Osteuropäische Geschichte |
| Betreut von / Supervisor: | Univ.-Prof. Dr. Oliver Jens Schmitt |

# Inhalt


Motivacioni ........ 4

1. Hyrja në temë ........ 6

   1.1. Historiku i shkurtër i angazhimit Amerikan në Kosovë ........ 8

   1.2. Vendi i hulumtimit ........ 11

   1.3. Pyetjet studimore ........ 13

   1.4. Metodat ........ 14

   1.5. Niveli i hulumtimit në shkencën shqiptare ........ 17

2. Biografitë e ish-presidentëve ........ 19

   2.1. Bill Clinton ........ 19

   2.2 Georg W. Bush ........ 20

3. Pse Clinton dhe Bush ........ 21

   3.1. Përshkrim i shkurtër i konfliktit Shqiptaro-Serb dhe internacionalizimi i çështjes së Kosovës. ........ 22

4. Imazhi i ish presidentëve në intervistat e zhvilluara me qytetarë të komunës së Gjilanit ........ 25

   4.1. Atmosfera politike dhe gjendja sociale si faktorë ndikimi në imazh. ........ 25

   4.2. Zhvillimi i intervistave dhe vështirësitë ........ 27

   4.3. Përceptimi i jashtëm ........ 28

   4.4. Ndikimi i moshës në krijimin e imazhit ........ 29

   4.5. Teknikat e intervistimit ........ 30

5. Bill Clinton dhe imazhi i tij ........ 31

   5.1. "Clintoni është një lloj shqiptari" ........ 31

   5.2. „Na për jet, kurr nuk kishum mujt mu çliru pa ndihmen e Amerikës" (v.1999-ës). ........ 33

   5.3. Krijimi i mazhit përmes vizitave ........ 35

   5.3.1 Familja Clinton ........ 36

   5.4. Mishërimi i politikave të presidentëve me politikat e shtetit ........ 37

   5.5 Prezenca e tij në kujtimet e familjeve ........ 39

   5.6 Kritika e zbehur ........ 40

6. Georg W. Bush dhe imazhi i tij në intervistat e zhvilluara në Gjilan ........ 42

   6.1. Bush dhe Kosova ........ 42

   6.2 Bush dhe karakteri i tij diplomatik sipas të intervistarve ........ 43

   6.3. „Veç të shqiptart ka ec pa trupëroje, se nuk u tut prej neve hiq" ........ 48

   6.4. Kritika ........ 49

7. Bill Clinton & Georg W. Bush – krahasime ........ 51

8. Kultura materiale ........ 53

8.1 Lagjja e Amerikaneve në Lladovë ... 57
8.1.1 Kalendarët vjetor ... 59
8.1.2 Libri me kopërtin të luftës në Kosovë ... 61
8.1.3 Asocimi i simboleve me përsonalitete politike ... 62
8.1.4. Krahasimi i tyre në imazhin e kulturës materiale ... 63
Përfundim ... 65
Bibliographie ... 67
Quellen aus web-Links ... 69
Abstract - Deutsch ... 71
Abstract - English ... 75

## Motivacioni

Temën të cilën do të trajtoj ka të bëjë me imazhin e dy ish- presidentëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në shoqërinë shqiptare në Kosovë.

Gjatë studimeve të mia në Universitetin e Vjenës kam vizituar ligjërata dhe seminare të ndryshme për nga tematika në të cilat pjesa dërmuese e tyre kanë ndikuar në thellimin e njohurive dhe zgjimin e interesit tim për tema më të specifikuara në lëminë e historisë. Por, gjithashtu disa nga temat e trajtuara për vendet e ndryshme të Europës Juglindore, rrallë herë janë trajtuar nga vetë historiografija e tyre për këto vende.

Ideja për temën ka ardhur nga seminari i ndjekur te profesor Oliver Jens Schmitt në Institutin e Europës Lindore të Universitetit të Vjenës me temën: "Krijimi i Miteve mbi Heronjët në Ballkan të shekullit XIX-XX", në të cilin seminar jam motivuar të mirrem më tutje me temën lidhur me imazhin e personaliteteve historike në shoqërinë e shtetit më të ri të Europës, Kosovën.

Në këtë seminar nga studentë të ndryshëm është trajtuar kjo temë duke pasqyruar krijimin e miteve mbi heronjët në Ballkan, temë e cila nuk ishte trajtuar në shkallë të duhur dhe nëse është trajtuar më shumë ka qenë me qëllim të përdorimit për interesa të caktuara politike si të kombeve, grupeve të ndryshme të shoqërive, synimi i të cilëve ishte mobilizimi i masës rreth qëllimeve të caktuara të tyre, respektivisht realizimi i interesave të tyre parciale, individuale, ditore, grupore apo nacionale.

Shikuar në aspektin kronologjik, në veçanti ishte interesant të shikoj se në çfarë forme janë krijuar mitet mbi heronjët në të kaluarën, sidomos karakterisitikat për të cilat dalloheshin heronjët në kohë**.** Karakterisitikë e përgjithshme e tyre ishte se heronjët nuk mund të gjeneralizohen dhe se çdo komb, grup religjioz ose grupe të ndryshme etnike kanë heronjët e tyre të cilët jo patjetër për grupe tjera të sipërpërmendura poashtu duhet të gëzojnë të njëjtin epitet dhe të trajtohen si të tillë.

Nisur nga fakti i historisë së akterëve dhe nga ajo se se çfarë bëjnë figurat dhe personat e shquar për një komb në momente dhe etapa të caktuara historike akterë të cilët zakonisht edhe janë

pjesë e atij kombi, në punimin tim do të mirrem me dy personalitete të përmasave botërore të cilët njihen për angazhime të ndryshme në politikën botërore dhe rrespektin për ta nga shqiptarët edhe pse ata janë akter joshqiptarë. Respekti për këto dy personalitete te populli i Kosovës, te shqiptarët në përgjithësi ku jetojnë si në Shqipëri, Maqedoni, Serbi apo në Diasporë, kanë krijuar një respekt në mënyrë të veçantë edhe pse për nga kombësija nuk i takojnë kombit të tyre.

Këtu do të trajtohet imazhi i dy ish- presidentëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si president të një fuqie botërore, të cilët ndër shqiptarët shikohen si personalitete të veçanta gjatë kauzes kombëtare dhe përpjekeve të popullit shqiptarë të Kosovës për liri dhe pavarësi. Nderimet për këto dy figura kanë zënë fillet e tyre nga koha e udhëheqjes si president të SHBA-ve njëri pas tjetrit në dy dekadat e fundit, gjegjësisht që nga koha e ballafaqimit të tyre politik direkt me popullin e Kosovës. Edhe pse tani këto dy personalitete e shijojnë jetën e tyre pas presidenciale dhe se fuqija e influencës së tyre politike në raport me Kosovën nuk është ajo e cila ka qenë gjatë kohës së qeverisjes së tyre, megjithatë nderi dhe respekti për këto dy personalitete pas disa viteve të angazhimit të tyre edhe në ditët tona nuk mungon. Populli shqiptarë i Kosovës çdo herë i kanë në kujtesë kujtimet për punën që kanë bërë për vendin e tyre. Këta kanë qenë në kohët e rëndësishme pranë shqiptarëve dhe për këtë arsye janë bërë pjesë e historisë së shqiptarëve në vitet (1999- 2009-së). Tema ime do të trajtojë imazhin e dy ish-presidentëve amerikan Georg W. Bush dhe Bill Clinton në shoqërinë shqiptare të Kosovës.

## 1. Hyrja në temë

Tema të cilën do e trajtoj ndryshon nga punimet apo shkrimet e ndryshme të natyrës së analizave lidhur me politikën amerikane ku në këtë kontekst trajtohet edhe roli i personaliteteve të veçanta dhe i ish- presidentëve amerikan, si persona me fuqinë më të madhe vendimëmarrëse në SHBA. Punimi im nuk do të trajtojë politikën amerikane në të kaluarën, apo rolin e tyre politik gjatë ngjarjeve të rëndësishme në Kosovë por është një trajtim i imazhit të dy presidentëve amerikan nga prizmi i qytetarëve të një lokacioni të caktuar në Kosovë të cilët do të paraqesin mendimet e tyre për këto dy personalitete.

Imazhin e figurave historike mund ta vrejmë në forma të ndryshme si në kulturën materiale poashtu edhe në kujtesën e njerzëve. Çdoherë dëgjohen bisedat nëpër kafene, familje apo në grupime të ndryshme shoqërore duke rikujtuar momente të veçanta nga angazhimi i tyre në të mirë të popullit të Kosovës. Emra të personaliteteve historike mbajnë sheshet, shkollat, rrugët si dhe janë ngritur monumente të ndryshme në shenjë nderimi dhe respekti për ta. Lufta e fundit në Kosovë e ka pasuruar historinë me heronjë, personalitete të reja historike si atyre me kombësi shqiptare dhe të atyre ndërkombëtare. Bill Clinton dhe Georg W. Bush janë emra të njohur në mesin e shumë të tjerëve për shoqërinë shqiptare në Kosovë. Një pjesë e imazhit të tyre mund të shihet thuajse çdo ditë në mediat Kosovare, si dhe në rrjetet e ndryshme sociale të cilat në shenjë mirënjohje shfaqin postime të ndryshme dhe shkrime të cilat kanë të bëjnë me Bill Clintonin apo Georg W. Bush-in.

Të dhënat për imazhin e këtyre presidentëve, të cilat do të përdoren në punimin tim janë mbledhur nga një shtresë e caktuar e shoqërisë kosovare të cilat nuk kanë asfar interesi politik. Pra, një shtresë tjetër e shoqërisë e cila simpatinë apo antipatinë për këto dy figura e sheh nga perspektivat e ndryshme krahasuar me njerëz të shtresës së klasës politike.[1]

Pas kalimit të një periudhe relativisht të gjatë nga përfundimi i luftës në Kosovë, e me këtë edhe nga koha në të cilën dy ish- presidentët më nuk udhëheqin me SHBA-të, për këtë arsye pas periudhave të sipërpërmendura dua të hulumtoj se çka ka mbetur në kujtesën e njerzëve lidhur me këto dy figura.

[1] Është fjala për një perspektivë të interesave përgjithshme kombëtare, duke mos qenë pjesë të politikes aktive përmes partive politike duke rrezikuar mbështetjen e mundshme Amerikane.

Për të pasur një imazh sa më të përafërt të tyre, duhet pasur parasysh shumë faktor të cilët janë determinues në këtë drejtim. Distanca kohore që nga periudha e luftës në Kosovë si pikë e rëndësishme në angazhimin amerikan në atë kohë nuk është e largët dhe se shumica e njerzëve janë dëshmitarë të gjallë të atyre ngjarjeve si dhe të periudhës së udhëhqjes së SHBA-së nga këto dy figura. Përveç angazhimit të tyre në Kosovë, dy presidentët janë të njohur për popullsinë poashtu edhe për aktivitetin e tyre politik ndërkombëtar në botë.

Lufta në Bosnjë, pastaj edhe në Afganistan dhe Irak janë ngjarje të rëndësishme të angazhimit të tyre politik të cilat padyshim se kanë influencuar në imazhin e tyre në popullin e Kosovës, popullsi e cila për nga përkatësia fetare njihet si popullsi me shumicë muslimane.[2]

Si momente kyçe të historisë më të re të Kosovës pas shpërbërjes së Jugosllavisë[3] konsiderohen dy ngjarje të rëndësishme në të cilat peshën kryesore e kanë bartur SHBA-të me angazhim direkt të presidentëve Bill Clinton dhe Georg W. Bush. Padyshim, intervenimi i NATO-së me 1999-ës[4] si dhe shpallja e pavarësisë së Kosovës, këto dy ngjarje madhore konsiderohen si ngjarje kryesore të cilat ndryshuan në masë jetën e qytetarëve të Kosovës. Në secilën nga këto dy ngjarje të cekura, SHBA-të udhëhiqeshin nga dy presidentët imazhin e të cilëve do e trajtojë në temën time. Por, roli i politikës amerikane padyshim se është i rëndesishëm edhe sot në Kosovë, ku çdo vizitë e zyrtarëve amerikan përcillet me interes nga qytetarët e Kosovës.

Bill Clinton në mesin e popullatës shqiptare në Kosovë shihet si çlirimtarë i shqiptarëve nga okupimi Serb. Kujtimi për të është shumë i freskët në shoqërinë Kosovare, ku gëzon një popullaritet të rëndësishëm në mesin e qytetarëve të saj. Në Prishtinë është ndërtuar një statuj e madhe për nder të tij dhe egziston një shesh i cili njihet me “Bulevardi Bill Clinton”. Përveç kësaj, çdo vizitë të cilën ai e bënë në Kosovë përveç pritjeve dhe protokoleve institucionale të

---

[2] Këtu kam parasysh se lufta në Irak dhe Afganistan të udhehëqura nga Georg W. Bush shifet nga perspektiva të ndryshme ku nga disa kritik është cilësuar si luftë me prapavijë fetare kundër shteteve me popullsi shumicë muslimane. Në anën tjetër ne rajonin e Gjilanit ballafaqohemi me një popullësi shqiptare me një shumicë më se mbi 95% të religjionit Islam. Këtu mund të nxjerrë poashtu një përfundim lidhur me rëndësinë e identitetit fetare tek Shqiptarët në rajonin e Gjilanit në raport me imazhin e ish presidentëve amerikan.

[3] Më shumë rreth shpërbërjes së Jugosllavisë shih: Marie-Janine Calic: Geschichte Jugoslawiens im 20. Jahrhundert. München: C.H. Beck 2010. F. 297-308.

[4] Më tepër rreth ngjarjeve politike, ushtarake dhe diplomatike rreth Kosovës gjatë periudhës 24 mars gjerë më 11 qershor 1999 te bombardimeve te Natos ne Kosovë shih: Arbend Kondi, Krimi i Fundshekullit. Tiranë: Ilar 2012.

cilat i bëjn një nderim të madh, poashtu edhe rrugët ku ai do të defiloj gjithmonë mbushen me qytetarë të shumët të cilët me padurim presin idhullin e tyre kombëtar.

Georg W. Bush, gjatë kohës sa ishte President i Amerikës bëri një vizitë të mbyllur në Kosovë.[5] Ai vizitoi ushtarët amerikanë të cilët shërbenin në kuadër të KFOR-it në Kosovë në kampin ushtarak amerikan Bondsteel në fshatin Sojevë të komunës së Ferizajit. Përkundër kritikave dhe atakimeve të ndryshme ndërkombëtare të cilat janë bërë në adresë të tij si President i SHBA-së për shkak të luftës në Afganistan apo Irak, mbështetja të cilën i dha shpalljes së pavarësisë së Kosovës e bënë atë një president mjaft të popullarizuar për popullin e Kosovës.

Gjersa "Bulevardi Bill Clinton"[6] gjendet në hyrje të Prishtinës, ai kryqëzohet në qendër të kryeqytetit me rrugën "Georg W. Bush", përmes së cilës kalohet në "Sheshin Nëna Terez". Ndërsa në Fushkrujë të Shqipëris, me 6 Korrik të vitit 2011-ës, gjegjësisht katër vite pas vizitës së tij në këtë shtet është ngritur një statuj e George W. Bush. [7]

Një rol të rëndësishëm në imazhin e këtyre dy presidentëve luajnë poashtu edhe mediat e shkruara dhe elektronike në Kosovë, të cilat përcjellin jo vetëm aktivitetin e tyre politikë pas kohës pos-presidencial por edhe jetën e tyre private.[8]

## 1.1. Historiku i shkurtër i angazhimit Amerikan në Kosovë

Amerika ka qenë një ndër shtetet e para e cila ka mbështetur Kosovën në forma të ndryshme, edhe pse në fillim më tepër është dukur vetëm si një mbështetje morale. Për këtë arsye një rol të rëndësishëm në historinë më të re të Kosovës nga të gjitha shtetet perëndimore luan posaçërisht politika amerikane e cila poashtu gëzon një mbështetje të konsiderueshme nga shqiptarët për angazhimin e saj në botë. Te shqiptarët, amerikanët shihen si një ndër të parët dhe të vetmit të cilët jo vetëm mbeshtetën lirinë e Kosovës, por edhe kanë sjellur atë. Së fundi, SHBA-të ishin të vetmit të cilët në mars të vitit 1999-ës i binden aleatët e NATO-s[9] për të filluar bombardimet kundër caqeve ushtarake dhe paramilitare Serbe në Kosovë dhe ish-Jugosllavi.

---

[5] http://www.nytimes.com/2001/07/25/world/bush-in-kosovo-tells-us-troops-role-is-essential.html (e parë për herë të fundit më: 16.09.2014).

[6] https://www.flickr.com/photos/sekitar/4586429987/ (e parë për herë të fundit më: 23.02.2015)

[7] http://www.koha.net/arkiva/?page=1,14,61429 (e parëpër here të fundit më: 16.09.2015)

[8] Më tepër rreth ndikimit të mediave në krijimin e imazhit shih: Julia Obertreis / Anke Stephan (Hg.): Erinnerungen nach der Wende. Oral History und (Post) Sozialistischen Gesellschaften. Essen: Klartext Verlag 2009. F. 32.

[9] Më shumë rreth fillimit të bombardimeve të Natos në ish Jugosllavi shih: Oliver Jens Schmitt: Kosovo, Kurze Geschichte einer zentralbalkanischen Landschaft. Böhlau Verlag Wien-Köln-Weimar 2008. F. 327.

Rolin më të rëndësishëm në këtë kohë luajti ish- presidenti amerikan Bill Clinton, si President i SHBA-ve i cili ishte një nga akterët kryesor i cili, pas luftës së Bosnës,[10] u bë një ndër akterët kyq në mbështetje të bombardimeve dhe kishte premtuar kthimin e refugjatëve ne vatrat e tyre. Ndërsa gjatë kohës së qeverisjes së Presidentit Georg W. Bush Kosova shpalli pavarësinë e saj duke u mbështetur fuqishëm nga SHBA-të, mbështetje e cila edhe në vitin 2012-ës nga qeverija amerikane dhe bashkëshortja e ish- presidentit amerikan Hillary Clinton në cilësine e sekretares së shtetit në forma të ndryshme nuk ka munguar. Sulmet 78 ditëshe ajrore të NATO-së kundër Serbisë detyruan ushtrinë dhe policinë Serbe të largohet nga Kosova, duke mundësuar kthimin në vatrat e tyre të më se 1. milionë shqiptarëve të cilët ishin të detyruar të largohen me dhunë nga Kosova pas një lufte e cila përfundoi me viktima të mëdha njerëzore dhe dëme të konsiderueshme materiale.

Pra, për shkak të kontributit të tij direkt për lirinë e Kosovës nga regjimi serb, Clinton është njëri ndër figurat më të respektuara në Kosovë. Menjëherë pas luftës, në vitin 1999 është instaluar administrata e UNMIK-ut në Kosovë, e cila kishta fuqinë juridike me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB[11]. Si administratë shumënacionale ajo u tregua tejet e paaftë dhe dhe e korruptuar, dhe me këtë edhe humbi simpatinë brenda popullatës kosovare. Për dallim, përderisa humbej besimi në administratën civile të UNMIKut, simpatia për trupat ushtarake të KFORit mbetej e njëjta, posaçërisht ndaj ushtarëve të kontigjentit amerikan.

Përderisa popullata shqiptare në Kosovë kishte një lloj skepticizmi sa i përket përkrahjes europiane në drejtim të pavarsisë së Kosovës, 9. vite pas përfundimit të luftës në Kosovë, derisa George W. Bush ishte president i SHBA më 17. shkurt 2007 Kosova shpall pavarësinë e saj. Shpallja e pavarësisë së Kosovës në periudhën e administirimit të SHBA nga presidenti Bush bëri që ai ndër shqiptarët të shihet si një ndër mbështetësit më të mëdhej të pavarësisë së Kosovës. Ai seriozitetin e angazhimit amerikan e kishte treguar qysh gjatë vizitës së tij të bërë në Shqipëri disa muaj para shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, ku ai edhe kishte kërkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë shpalljen e pavarësisë së Kosovës[12] dhe me këtë edhe kishte hequr dilemën dhe pyetjen e madhe të popullatës rreth shtetësisë së Kosovës.

[10] Për rolin e Clinton-it në Bosnje shih: Holm Sundhausen: Jugoslawien und seine Nachfolgestaaten. Wien/Köln/Weimar 2012. F. 361.
[11] Holm Sundhausen: Geschichte Serbiens 19.-21. Jahrhundert. Wien/Köln/Weimar 2007. S. 438.
[12]Krahasim poashtu: Albanien – Besuch. Bush fordert schnelle Unabhängigkeit für das Kosovo. Në: SpiegelOnline http://www.spiegel.de/politik/ausland/albanien-besuch-bush-fordert-schnelle-unabhaengigkeit-fuer-das-kosovo-a-487732.html (e parë për herë të fundit më: 02.11.2015)

Edhe sot, kur shohim njohjet ndërkombëtare të pavarësise së Kosovës, një proces jo i lehtë i cili vazhdon të mbetet edhe më tutje një agjendë kryesore e politikës së jashtëme kosovare, vërehet çartazi roli i amerikanëve si një ndër përkrahësit më të rëndësishëm në këtë drejtim. Simpatinë amerikane në raport me Europën e ngrit edhe më tutje fakti që Kosova ende nuk është njohur nga 5 shtete të BE-së. E një politikë e tillë e amerikanëve brenda popullatës shqiptare të Kosovës ka krijuar ndjenjën e sigurisë. Andaj thënia sipas së cilës *„Amerikanët dhe Zoti e kanë shpëtuar Kosovën"* nuk ështe tani një thënie interesante por si diçka e zakonshme kur njeriu dëgjon çdo ditë këto shprehje duke e krahasuar Ameriken me Zotin i cili i mbron njerëzit, ndërsa ushtarët amerikanë cilësohen si engjuj të tij. Kur flasim më tepër për ushtrinë amerikane dhe borgjin ndaj saj që ndjejnë shqiptarët në përgjithësi, flet më së miri angazhimi i një femre nga fshati Livoç i Poshtëm i komunës së Gjilanit e cila si fëmijë refugjate gjatë luftës me familjen e sajë kishte emigruar në Amerikë. Krahas studimeve të psikologjisë dhe matematikës dhe të marrëdhënjeve ndërkombtare në SHBA ajo kishte përfunduar edhe akademinë ushtarake në SHBA dhe tani bënë karierrë në ushtrinë amerikane ku përveç se shpesh viziton vendlindjen e vet, së fundëmi ka shërbyer poashtu si ushtare amerikane në Kosovë në kuadër të KFOR-it. Edhe pse ka studiuar edhe në fusha tjera, familja e saj duket të ketë qenë nga mbështetësit e saj më të mëdhej për të shërbyer në kuadër të ushtrisë amerikane e shtyrë nga ndjenja dhe obligimi për të i kthyer sado pak një borxh për mbështetjen amerikane gjatë luftës në Kosovë.[13]

Një proces i tillë brenda popullatës shqiptare ka ndikuar mjaft shumë në ngritje të skajshme të simpatisë dhe rrespektit jo vetëm për SHBA-të si institucion shtetëror por edhe për shtetasit e sajë. Në librin e saj Saskia Durde interviston një amerikan i cili jeton në Kosovë, respektivisht dekanin e Universitetit Amerikanë në Kosovë i cili pohon: "*Unë nuk mundem të bëjë këtu gabime, nëse ndonjëherë vozis shpejt, polici mbyll një sy, vetëm se unë jam amerikan*".[14]

Nëse gjendeni në Prishtinë i cili është njëherit kryeqyteti i Kosovës, mund të shihet se si një shesh është emëruar me emrin e Bill Clintonit, ose aty pranë një rrugë tjetër me emrin e Madeline Albright ose të Georg W. Bush. Në sheshin Bill Clinton mund të shihet statuja e tij e madhe e cili me dorën e ngritur lartë, përshëndet kalimtarët e rastit natë e ditë. Përveç Bill Clinton-it dhe Georg W. Bush-it, një popullaritet dhe respekt të madh te qytetarët gëzon poashtu edhe ish- kryeministri britanik Tony Blair, i cili i kishte dhënë mbështetje të fortë poltikës

[13] http://illyriapress.com/left-kosova-war-refugee-returned-soldier-us-army/ (e parë për herë të fundit më: 28.04.2015)

[14] Cituar sipas: Saskia Drude: Hundert Wochen Kosovo. Alltag in einem unfertigen Land. Fischer. Aachen 2008. f. 208.

amerikane gjatë sulmeve ajërore të NATO-së kundër caqeve Serbe, dhe ishte njëri ndër aktorët kryesorë politik dhe mbështetës i Presidentit Cllinton gjatë asaj kohe. Janë të njohur disa fëmijë të cilët kanë lindur gjatë kohës së luftës në Kosovë ose menjëherë pas përfundimit të saj të cilët janë pagëzuar me emrin Bill ose Clinton[15], Tony, Tony Blair (Tonibler). [16]

Populariteti i dy ish- presidentëve në të shkuarën e afërt poashtu edhe sot është i madh në popull. Ashtu si në të kaluarën, gjithashtu edhe sot mund të gjinden kudo gjurmët e imazhit të tyre si nëpër rrugë përmes bill boards, postinge të ndryshme, fotografi etj. Me kalimin e kohës ky kujtim dhe këto gjurmë me intensitet të ndryshëm janë ende të pranishëm në mesin e qytetarëve të Kosovës. Kur kemi parasysh krahasimin e vendbanimeve urbane dhe atyre rurale në raport me shtrirjen e kulturës materiale, monumentet e ngritura si dhe rrugët e emëruara sipas emrave të tyre janë karakterisitikë kryesisht për vendet urbane respektivisht në qytetet më të mëdha të Kosovës si vende më të frekuentuara urbanistike. Por, një kujtesë e veçantë mund të gjendet poashtu edhe nëpër fshatrat e Kosovës, ku me iniciativa private në vende të ndryshme mund të gjenden grafite të shkruara, fotografi apo shkrime në mbështetje të politikës amerikane si dhe të ish- presidentëve amerikanë.[17]

Qëllimi i këtij punimi nuk është hulumtimi i imazhit të dy ish- presidentëve në mbarë teritorin e Kosovës, por do të përqendrohem në një lokacion të caktuar në Kosovë për të hulumtuar atë në mesin e popullatës së atij rajoni. Por, rezultatin të cilin do e nxjerri nga ky lokacion nuk do të thotë se mund të jet një imazh i mbyllur përkundër karakteristikave të veçanta që mund ti ketë. Ky imazh poashtu është një pasqyrë e përafërt në mbarë popullsinë shqiptare në Kosovë për shkak të kaluarës së përbashkët historike, dhe për këtë mund të konstatojmë se kur është fjala për amerikanët gëzojnë të njëjtin popullaritet të shqiptarët kudo që jetojnë në Ballkan apo në Diasporë.

### 1.2. Vendi i hulumtimit

Vendi i hulumtimit do të jet një qytet me rrethinë i cili shtrihet në pjesën juglindore të Kosovës i cili gjendet 47 km larg kryeqytetit të Kosovës Prishtinës, me një sipërfaqe prej 515 km/2 me

[15] http://www.albeu.com/shqiperi/clinton-te-dielen-ne-prishtine/13920/ ( e parë për herë të fundit më: 23.04.2015)

[16] http://shqiptarja.com/video/index.php?IDVideo=24531&IDCategoria=7 (e parë për herë të fundit më: 23.04.2015)

[17] Krahasimi fshat-qytet ka më shumë te bëjë me formën e organizimit institucional, ku sa i përket monumenteve të personaliteteve ndërkombëtare më tepër është përqendruar në qytete për shkak të frekuentimit më të madh si qendra administrative institucionale. Ndërsa për emëra të rrugëve në fshatra, tani në vitin 2012 nuk mund të flitet për një emërim të përgjithshëm të rrugëve nëpër fshatra ku shumica e tyre qëndrojnë pa emra.

gjithsej 63 vendbanime. Për nga rëndësija administrative dhe madhësija gjeografike i cili ka në shtetin e Kosovës, është njëra ndër shtatë komunat më të mëdha në Kosovë. Kur kemi parasysh edhe ndarjen regjionale të Kosovës, Gjilani është qendër kryesore administrative e rajonit të Anamoravës.[18] Për nga numri i popullsisë Gjilani ka mbi 150 mijë banorë, strukturën nacionale të së cilës e përbëjnë shumicën Shqiptarët, pastaj vinë pakicat tjera minoritare, siç janë: Serbët, Romët, Turqit etj.[19]

Atë çka e bënë më karakterisitike komunën e Gjilanit në raport me amerikanët është fakti që pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe vendosjes së trupave të NATO-së në këtë shtet në vitin 1999-së, rajoni i Anamoravës ka qenë dhe është pjesë e përgjegjësisë së sigurisë së Ushtrisë Amerikane.[20] Me formimin e bazës më të madhe ushtarake amerikane në Kosovë në një fshat në rajonin Anamoravës jo larg Gjilanit, ka bërë të mundur një prezencë më të madhe amerikane në këtë rajon krahasuar me rajonet tjera të Kosovës.

Baza amerikane e ngritur në fshatin Sojevë e cila njëherit është një nga bazat më të mëdha amerikane në Ballkan, i ka mundësuar popullatës së kësaj ane që këta ushtarë ti takojë në çdo rrugë[21] të Gjilanit dhe fshatërave për rreth, duke patrulluar për të kontribuar në ruajtjen e sigurisë dhe ofrimin e ndihmave të ndryshme për popullsinë e kësaj ane. Por edhe veprimet e tyre nganjëher negative mund të kenë krijuar një imazh në veti.[22]

Në vendin ku është ndërtuar baza amerikane në fshatin Sojevë të rajonit të Anamoravës afër 30 km larg Gjilanit, presidenti i atëhershëm amerikan Georg W. Bush gjatë një vizite të mbyllur[23] të bërë këtij kampi ushtarak është pritur edhe nga popullsija e kësaj ane edhe pse për nga numri ka qenë e vogël për shkak të mundësive të kufizuara teknike të bazës ushtarake, por entuziazmi ka qenë i madh për të marrë pjesë aty çka edhe sot kujtohet nga qytetarët në Kosovë.

---

[18] Gejografikisht Kosova ndahet nërajonin e Drenicës, Anamoravës, Dukagjinit dhe Llapit. Si qytete më të njohura të rajonit te anamoravës janë: Gjilani, Ferizaji, Vitija, Kamenica, Artana etj.

[19] https://kk.rks-gov.net/gjilan/City-guide/Geography.aspx (e parë për herë të fundit më: 26.04.2015)

[20] Kosova është ndarë në 4 zona ushtarake të sigurisë: Amerikane, Franceze, Angleze, dhe Italiane.

[21] Pranija më e madhe fizike e tyre ka qenë menjëherë pas luftës në Kosovë dhe disa vjet më pas krahasuar me ditët e sodme. Kjo për arsye të mungesës së policisë vendore dhe sigurisë më të brishtë e cila ka qenë në të kaluarën.

[22] Jo pak qytetarë të Gjilanit përkujtojnë poashtu edhe rastet konfliktuoze me ushtarët Amerikan (ku dëshmitar i këtyre ngjarjeve të pas luftës ka qenë edhe autori i këtij punimi) të cilët menjëherë pas luftës në Kosovë gjatë kalimit nëpër zonat e banuarame serb pengonin perdorimin e simboleve kombëtare gjatë ceremonive të ndryshme tradicionale, apo edhe vendosjen e orës policore më se dy vjet me radhë në këtë rajon.

[23] Kur them vizitë të mbyllur, kjo ka qenë një blic vizitë e bërë enkas për ushtarët Amerikan dhe nuk ka qenë vizitë e hapur qoftë për ti bërë institucioneve shtetërore, apo edhe për të frekuentuar rrugëve të ndonjë qyteti të Kosovës ashtu siq ngjanë shpesh me zyrtare të ndryshëm Amerikan.

Në anën tjetër popullësia në vet qytetin e Gjilanit për nga struktura urbane është e larmishme. Gjilani në të kaluarën e afërt deri në kohën e luftës së fundit në Kosovë të vitit 1999-së, ka qenë një qytet realitivisht i vogël krahasuar me kohën e tashme. Ata të cilët në popull quhen „*Qytetarë Vendas*“[24] në shikim të parë në rrugët e Gjilanit nuk mund të dallohen nga një fshatar i ardhur në qytet. Rritjen gjeografike dhe demografike më të madhe ky qytet e ka pasur pas luftës së fundit në Kosovë, ku një pjesë e madhe e popullsisë janë të ardhur nga fshatrat për rreth, të cilët tani jetojnë të përzier me popullsinë vendase. Këtu duhet poashtu theksuar se Gjilani si qendër administrative e komunave Gjilan, Kamenic, Viti dhe i fshatrave të tyre çdo ditë frekuentohet nga fshatarë të këtyre komunave të cilët qytetin e shfrytzojnë qoftë si vend tregu, shkollimi apo edhe argëtimi. Si pasojë e kësaj, intervistat e zhvilluara në vendet më të frekuentuara të qytetit kanë poashtu përzierje të balancuar Urbano-Rurale për ti përfshirë poashtu edhe fshatërat për rreth.[25]

Përveç arsyeve të cekura është edhe motivi im personal pasi prejardhja ime është nga kjo komunë dhe kam lindur jam edukuar dhe punuar aty për një kohë të gjatë. Janë këto poashtu disa nga motivet të cilat kanë bërë që të kem njohuri më të thelluara për strukturën e popullsisë në këtë komunë, për kulturën, gjeografinë etj, çka më mundësojnë përmes kontakteve të mija të kem të dhëna më të hollësishme në këtë drejtim për të takuar qytetarë me një përfshirje më të gjerë gjeografike në intervistim.

## 1.3. Pyetjet studimore

Po të hulumtohej kjo temë në një periudhë të mëhershme të pas luftës në Kosovë do të kishte një prezenc shumë më të madhe të burimeve në hulumtimin e kulturës materiale ku entuziazmi ndaj këtyre personaliteteve ishte më i theksuar për shkak të situatës politike dhe plagëve ende të freskëta nga lufta në Kosovë. Ndërsa në fushën e intervistave është një intensitet tjetër pasi që kujtimet e tyre janë ende të freskëta dhe në këtë botë të informacioneve të bollshme nuk është vështirë që qytetarët të reflektojnë në imazh për çdo personalitet të rëndësishëm kombëtar apo botëror.

Pyetjet studimore janë:

- **Cili është imazhi i figurave të dy presidentëve amerikan Bill Clinton dhe Geroge W. Bush në Kosovë: pozitiv ose negative?**

---

[24] Qytetarë të cilët së paku prindërit e tyre kan lindur në qytet dhe vet po aty janë rritur.

[25] Edhe pse intervistat me fshatarë të ndryshëm nëpër fshatra nuk kan munguar.

- **Cilët janë faktorët kryesor të cilët kanë ndikuar më tepër në imazhin e tyre në Kosovë?**
- **Dallimet e tyre në imazh?**

Në këtë drejtim po ashtu nuk mungojnë pyetjet tjera interdiciplinare të ndërlidhura me imazhin e tyre të cilat do ti plotësojnë pyetjet kryesore gjithnjë për të ardhur në një rezultat më të përafërt të imazhit të tyre.

Rezultati do të arrihet përmes analizave dhe interpretimit të intervistave të bëra në Gjilan, si dhe të hulumtimit të kulturës materiale si pjesë e planit të punës sime në teren të cilat do të sistemohen dhe analizohen sipas relevancës së tyre.

### 1.4. Metodat

Influenca politike e SHBA-së në Kosovë është më se e dukshme. Kjo mbase mund të vërehet në shumë sfera por sidomos brenda klasës politike të saj ku gjatë periudhës elektorale kanë peshë të rëndësishme dhe nganjëherë dominante ku mund ndikojnë edhe në fushaten elektorale të partive të ndryshme politike[26]. Për këtë arsye e kam parë të rrugës për të pasur një imazh sa më të balancuar dhe më të përafërt të këtyre dy personaliteteve në Kosovë, të bëjë një përzgjedhje selektive të të intervistuarëve duke u tërhjekur nga njerëzit e jetës publike dhe të politikës aktive të cilët janë të ndikuar nga këto procese.

Prandaj ata të cilët e vlerësojn punën e dy ish -presidentëve të lartëpërmendur amerikan nga një perspektivë tjetër, janë padyshim populli i thjeshtë i cili në bazë të kujtimeve të së kaluarës japin mendimin e veta pa frikë dhe influenc politike, më tepër i shtyrë nga përvojat personale dhe mbijetesa në kohët e vështira të së kaluarës. Përveç kësaj edhe vlerësimi i këtyre figurave nga klasa politike në Kosovë ka një rëndësi të veçantë, dhe në rast të ndonjë mendimi negativ për këto dy figura do të intepretohej si një anti amerikanizëm e cila do ti kushtonte me humbjen e konsiderueshme të elektoratit të saj.

Do të shtrohen pyetjet se çfarë domethënie kanë këta dy emra në popullin e Kosovës dhe se çfarë mendimi kanë për personalitetet e tyre. Meqenëse hulumtimi im ka të bëjë me imazhin e tyre brenda qytetarëve të Gjilanit, prandaj jam i detyruar më shumë që pjesën më të madhe të hulumtimit ta bëjë përmes intervistave, respektivisht të përdori historinë gojore.

[26] Kjo bëhet më shumë përmes ambasadës Amerikane në Kosovë.

Për arsyet e cekura më lartë, puna në teren merr pjesën time më të madhe të hulumtimit. Për të pasur një rezultat sa më të baraspeshuar të imazhit të tyre, njerzitë të cilët do të intervistohen[27] do të përpiqem ti gjejë nga kategori të ndryshme shoqërore gjithnjë duke pasur parasysh elementin e jetës civile. Ata do të ndahen sipas moshës,[28] profesionit, nivelit arsimor[29] dhe shtresës sociale. Ky konglomerat i njerzëve do të plotësoj imazhin e ish- presidentëve përmes mendimeve të ndryshme që nuk është e thënë se duhet të jenë të njejta.

Varësisht nga niveli arsimor i të intervistuarve kemi edhe shprehje të ndryshme në aspektin gramatikor të të shprehurit. Të gjitha mendimet e të të intervistuarve do të paraqiten në mënyrë origjinale të dialektit lokal pa ndonjë ndërhyrje për qëllime drejtshkrimore nga unë.

Pjesë e rëndësishme e imazhit të figurave të ndryshme historike poashtu është edhe kultura materiale përmes së cilës reflektohet imazhi i tyre në shoqëri. Çdo vizitë e personaliteteve të ndryshme ndërkombëtare të cilët shquhen veçanërisht për kontributin e dhënë gjatë luftës në Kosovë, organizohen pritje protokolare shtetërore dhe përcillet me një hapësirë të veçantë mediale për të mbuluar në mënyrë sa më të mirë vizitat e tyre.[30] Qytetarë të shumtë në numër të konsiderueshëm janë gjithmonë prezentë gjatë çdo vizite të hapur, përurime dhe mirënjohje[31] të ndryshme të cilat për nderë të tyre organizohen në Kosovë.

Si pjesë e kulturës materiale në mes të tjerave do të mblidhen grafite apo foto të ndryshme të vendosura në qytetin e Gjilanit dhe të fshatërave për rreth ku do të bëhet një analiz dhe interpretim i këtyre figurave si dhe për të gjetur arsyen e vendosjes së tyre në ato vende.[32] Gjithë ajo çka mund të gjendet në këtë drejtim, pavarësisht kohës së bërjes së tyre janë pjesë e imazhit të krijuar në shoqërinë shqiptare në komunën e Gjilanit dhe në Kosovë.

---

[27] Më tepër për mënyrën e intervistimit shih: Kobi Kabalek: Spuren vergangener Geschichte/n, Die NS-Zeit in Interviews mit Jungen Deutschen aus der ehemalige DDR. Në: Erinnerungen nach der Wende, Oral History und (post)sozialistische Gesselschaften: Julia Obertreis/ Anke Stephan (Hg.). Klartext Verlag, Essen 2009 F. 121-124.
[28] Këtu kam parasysh se një pjesë e shoqërisë së moshës më të vjetër mbi 30 vjeçare, janë ata të cilët kohën e qeverisjes së tyre e kan përjetuar si dëshmitarë të kohës. Këtu duhet të kem parasysh veçanërisht ish presidentin Bill Clinton, i cili kulmi i angazhimit të tij politik në Kosovë në krahasim me ish presidentin Georg W. Bush është më e largët, dhe se një pjesë e rinisë së Kosovës e moshës 18-30 vjeçare emocionet për luftën e Kosovës në krahasim me ata të moshës më të vjetër janë të ndryshme.
[29] Ketu parasëgjithash student, intelektual, njerëz me shkollim të mesëm etj.
[30] Gjatë kohës së intervistimeve të mija në Gjilan prej datës 15-30 tetorë 2012, në hyrje te Gjilanit shiheshin Bill Board të bashkëshortës së ish presidentit Amerikan Bill Cllinton e cila në cilësin e sekretares së shtetit Amerikan ato ditë do të bënte një vizitë në kryeqytetin e Kosovës për tu takuar me liderët vendas. Krahas saj mund të shiheshin poashtu bill board të ish gjeneralit të ushtrisë Amerikane Wesley Clark, i cili para disa ditëve kishte vizituar Kosovën.
[31] Poashtu ish presidenti Clinton është shpallur doktor Honoris Causa i Universitetit të Prishtinës.
[32] Për shembull arsyen e vendosjës së tyre në ndonjëherë në fund të ndonjë rruge. Ku është qëllimi I shoqërimit të këtyre dy personaliteteve me personalitete të caktuara vendore etj.

Si model për temën time do të shërbehem me dy punime të autorëve joshqiptarë të shkruara nga Stephanie Schwanders Silver dhe dhe Anna Di Lellio *„The Legendary Commander: the construction of an Albanian master-narrative in post-war Kosovo"*, të cila në bazë të punës në teren duke u marrur me hulumtimin e burimeve gojore, si dhe të kulturës materiale paraqet imazhin e Adem Jasharit te vizitorët e këtij kompleksi. Adem Jashari ishte një ndër figurat më të rëndësishme me të cilën identifikohet rezistenca e armatosur e shqiptarëve në Kosovë.[33]

Në këtë libër janë hulumtuar mbetjet e mbetura të shtëpisë së Jasharve në Prekaz e cila ishte granatuar në vitin 1997-ës, shtëpi e cila tani shërben si muze ku vizitohet nga mijëra vizitor.[34] Autorja përshkruan vendin si një atrakcion për vizitorë dhe përpiqet ti hulumtoj arsyet dhe gjurmët në bazë të cilave është bërë ky vend atraktiv për vizitorë dhe ç´farë imazhi paraqet për ta. Për të shprehur përshtypjet e tyre lidhur me kullën e Jasharve, aty qëndron libri i vizitorëve, ku çdo vizitorë ka mundësi të paraqet përshtypjet e veta për këtë histori. Kultura materiale e cila është prezente në këtë Kullë, poashtu paraqetë një rëndësi të veçantë në hulumtimet e autoreve lidhur me imazhin e familjes Jashari në punimin e tyre. Sa i përket anës artistike aty gjenden disa foto të cilat portretizojnë figurat e Adem dhe Hamz Jasharit në forma të ndryshme të cilat ofrojnë imazhin e trimave për liri, të luftëtarëve të paepur për lirinë e Kosovës. Aty mund të gjenden poashtu gjëra të tjera nga kultura materiale si: Pulla postare, kalendarë, medalje, orë, libra si dhe suvenire të ndryshme të cilat mund të blihen nga njerëzit, ku paraqitet imazhi i Adem Jasharit si një luftëtar i vërtet, i armatosur me mjekrrën e tij dhe Plisin, si një simbol kombëtar i shqiptarëve.

Një pjesë e rëndësishme e hulumtimit të saj është imazhi i Adem Jasharit në qytete të ndryshme të Kosovës duke intervistuar njerëz të ndryshëm në kafene apo kalimtar të rastit nëpër rrugë. Provon të gjenë dallimin e imazhit në vende të ndryshme në Kosovë duke pasur parasysh orientimin politik të shumicës së qytetarëve të qyteteve të ndryshme në Kosovë.
Intervistat si dhe fotot e marra në teren do të përpunohen sipas relevances së tyre, duke i sistematizuar sipas pyetjeve hulumtuese për ti analizuar faktorët e ndryshëm që kanë ndikuar në formimin e opinionit të tyre për këto personalitete për të ardhur në një rezultat sa më të përafërt të imazhit të tyre në shoqëri.

[33] Adem Jashari është si simbol i rezistencës së armatosur, hero kombëtar i cili rrjedhte nga shoqërija fshatare. Ai njihet si një nga komandantët më të rëndësishëm të UÇK-s, i cili madje i ka dhënë historisë së shqiptarëve një drejtim tjetër. Në mars të vitit 1997 policija sulmojë gjithë familjen ku dhe vrau 54 anëtarë të familjes Jashari.

[34] Fshati Prekaz së bashku me Gllogjanin konsiderohen si një nga vendet më të rëndësishme të rezistencës së luftës së fundit në Kosovë. Për shkak të respektit për këto familje (Jashari dhe Haradinaj) këto dy vende janë shëndrruar në vende atrakcioni ku çdo ditë vizitohen nga vizitorë të ndryshëm.

## 1.5. Niveli i hulumtimit në shkencën shqiptare

Kur flitet për politikën amerikane ndaj Kosovës, vështirë që mund të gjindet një punim për historinë më të re të Kosovës në të cilën të mos jet i cekur roli amerikan dhe i ish- presidentëve Cllinton dhe Bush për luftën e vitit 1999-ës dhe shpalljen e pavarsisë së Kosovës në vitin 2007. Poashtu si punime biografike kemi biografitë e tyre të shkruar nga vet ish- presidentët amerikan, ku padyshim angazhimi i tyre në Kosovë trajtohet si sukses i angazhimit të tyre për ti mbrojtur vendimet e tyre politike dhe ligjet ndërkombëtare për lirinë dhe të drejtat e njeriut, respektivisht për ndaljen e gjenocidit Serb ndaj popullit shqiptarë.

Por nuk mund të gjindet ndonjë kërkim shkencor i cili është marrur me imazhin e dy ish-presidentëve në shoqërinë Kosovare por edhe të vendeve për rreth. Shikuar në përgjithesi kërkimet mbi imazhin e personaliteteve të ndryshme si nga e kaluara por edhe në të tashmen, është një fushë studimi e cila fare nuk është prekur nga publicistika shkencore në Kosovë. Edhe pse në munges të këtyre publikimeve, qytetaret e Kosovës janë përkujdesur për shumë të rënë dhe ata që kanë mbijetuar luftën që në ditët e sotme të nderohen si heronjë (ish luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo aktivist të partive politike të rënë në luftë) dhe për shumë prej tyre janë ngritur përmendore, janë emëruar sheshe, shkolla, apo institucione të ndryshme me rëndësi të veçantë mbajnë emrin e tyre. Konferenca e Rambullies, intervenimi i NATO-së, përfundimi i luftës deri te shpallja e pavarësis të cilat konsiderohen si ngjarje të mëdha, kanë zgjuar interes të madh si nga autor vendor poashtu edhe ndërkombëtar. Egzistojnë një numër i madh punimesh ku trajtohet situata politike që nga fillimi i konfliktit, shpërbërja e Jugosllavisë deri te shpallja e pavarësisë së Kosovës, dhe në këtë kontekst trajtohet roli i aktorëve të ndryshëm si të brendshëm poashtu edhe të jashtëm. Në kuadër të kësaj dhe lidhur me këtë roli i amerikanëve gjatë kohës së udhëheqjes së Bill Clinton-it dhe Georg W. Bush mirret parasysh në forma të ndryshme dhe gjithmonë roli i tyre është paraqitur në mënyrë pozitive si ndër më besnikët te autorët shqiptarë, imazh të cilin e gëzojnë edhe sot amerikanët të popullin shqiptarë.

Pse mungon ndonjë punim shkencor lidhur me imazhin e këtyre dy presidentëve në Kosovë? Arsyeja e parë është imazhi pozitiv i këtyre dy ish-presidenteve si brenda popullit poashtu edhe në historiografinë shqiptare që është i madh dhe gjendja politike aktuale në relacionet Amerikë-Kosovë ku çdo personalitet amerikanë asocion me politikën Amerikane dhe nevojën mbështetjes së tyre është një faktor i rëndësishëm në këtë drejtim.[35] Arsyeja tjetër përse nuk

[35] Këtu duhet cekur më tepër kritika në drejtim të ish-presidentit Bush i cili në pjesën më të madhe të botës ka një imazh të një presidenti i cili ka sjellur konflikte.

është shkruar ndonjë punim shkencor lidhur me këto dy figura është pikërisht ky imazh pozitiv i këtyre dyve që gëzojnë si në mesin e popullsisë, në institucionet politike, poashtu edhe në qarqet akademike Kosovë dhe Shqipëri.

Punimi im mirret me imazhin e këtyre ish- presidentëve nga një shtresë tjetër e popullsisë dhe asesi me imazhin e tyre në mesin e shtresës së njerzëve publikë, gjegjësisht me ata të cilët në një mënyrë a tjetër në të kaluarën apo tashmën janë influencuar nga politika. Unë do të hulumtoj imazhin e tyre në mesin e popullsisë të cilët nuk janë aktiv në politikë dhe si pasoj e kësaj informatat mbi politikën dhe imazhin e tyre i kanë marrur nga mediat. Poashtu edhe zhvillimet politike ndërkombëtare nuk janë larg syve të publikut ku angazhimi direkt i ish-presidentëve amerikan në politikën e jashtëme është i njohur[36] kur dihet barra e tyre në këto zhvillime. Me zhvillimin e teknologjisë informative është mundësuar marrja e informatave të ndryshme si nga kritikët poashtu edhe përkrahësit e tyre duke mundësuar që të kenë informata sa më të balancuara për ta.

[36] Këtu duhet përmendur sistemin e qeverisjes Amerikane ku roli i presidentit është i gjerë në vendimëmarrje, i cili njëkohësisht është edhe udhëheqës i forcave të armatosura. Poashtu çdo vendim për intervenim ushtarak Amerikan në botë varet nga fjala e tij i cili njëherit urdhëron poashtu edhe intervenime të ndryshme në zona konfliktuoze. Lufta në Kosovë, gjegjësisht urdhëri i Bill Clinton-it për intervenim. Lufta në Irak, Afganistan, roli I ish presidentit Georg W. Bush për intervenime nëkëto vende, padyshim se këto përgjegjesi i bëjnë të jenë në qendër të vëmendjes ne publik. Për këtë arsye luftërat Amerikane identifikohen më shumë përmes presidenteve të tyre, të cilat reflektojnë në imazhin e tyre në botë.

# 2. Biografitë e ish-presidentëve

## 2.1. Bill Clinton

Presidenti i 42-të i Shteteve të Bashkuara të Amerikës Bill Clinton është lindur më 19 gusht 1946 në Hope të Arkansas të SHBA-së. Është i martuar me sekretaren e tanishme (v.2012-ës) të SHBA-s e cila në këtë pozitë shërben gjatë mandatit të parë presidencial të presidentit Barack Obama. Më 1964-ës regjistroi studimet në fushën e marrdhënieve ndërkombëtare në Universtitetin Georgetown. Gjatë studimeve të tij kishte punuar punë të ndryshme për të mbuluar nevojat e tij jetësore. Por, gjatë aty studimeve ai takoj poashtu edhe gruan e tij Hillary-n me të cilën u martua në vitin 1975-ës, ku më 1980-ës lind fëmija i tyre i vetëm, Chelsea Victoria Clinton.

Angazhimi i tij në politikë daton që nga mosha rinore e tij, duke marr pjesë në lëvizje të ndryshme studentore. Pas diplomimit të tij në Gerogetown, Cllinton fitoj bursën prestigjioze Rhodas për të studjuar dy vite në Universitetin e Oxford-it.

Kariera e tij politike qeverisëse për të kandiduar për një vend në dhomën e përfaqësuesve filloj në vitin 1974-ës duke humbur garën një rrethinë e cila konsiderohej si një bastion i republikaneve. Ajo çka më së tepërmi është e lidhur me Kosovën gjatë karieres së tij politike ishte koha e qeverisjës së tij dy mandatore[37] si President i SHBA-së e cila fillon me fitoren e tij në zgjedhjet presidenciale si kandidat i partisë demokratike ndaj rivalit të tij republikan Georg Bush më 3 nëntor të vitit 1992-ës, post të cilin e mbajti gjerë më 20 janar të vitit 2001-ës.[38]

Koha e qeverisjes së tij përkon me ngjarje të rëndësishme politike në Ballkan, të cilat pas rënies së murit të Berlinit dhe shpërbërjes së bashkimit Sovjetik erdhi poashtu deri te shpërbërja e Jugosllavisë e cila ishte e përcjellur me luftëra të përgjakshme. Qeverija Cllinton njihet për angazhimin e saj në këto konflikte në drejtim të sigurimit të paqes në këtë rajon, posaçërisht në rastin e Kosovës. Angazhimi i tij direkt në këtë konflikt i ka shërbyer poashtu për tu cilësuar si një nga sukseset më të mëdha gjatë kohës së tij si President duke pasur përkrahjen e shumë amerikanëve ndaj politikave të tij në drejtim te Kosovës, përkrahje thuajse e pakrahasuar gjatë angazhimit amerikan në konfliktet e tjera në botë.

[37] Më 2001 fiton mandatin e dytë presidencial ndaj rivalit të tij republikan Bob Dole.
[38] Më tepër mbi jetën e tij, shih: Bill Clinton: My Life. New York: Alfred A Knopf 2004. Auch als pdf Donloadbar unter http://www.gyxsqex.com/tushu/book/book23/2009893425219.pdf (e parë për herë të fundit më: 14.01.2016)

Gjatë kohës së tashme (V.2012-ës), Bill Clinton është angazhuar në luftën kundër Aids-t ku dhe ka themeluar fondin për luftimin e kësaj smundje në botë.

## 2.2 Georg W. Bush

Georg W. Bush pas 8 viteve të qeverisjes së demokratëve do të sjell prap në skenën politike të SHBA-së partinë republikane, kësaj radhe përmes të zgjedhurit si president të djalit të ish-presidentit të 41-t amerikan Georg Herbert Walker Bush. Georg Walker Bush i cili shkurtimisht njihet si Georg W. Bush, apo si Georg Bush Junior (Georg Bush i riu), është lindur më 6 korrig të vitit 1946 në New Haven të Connecticut. Gjatë periudhës 1964-1968-ës, ndjeki studimet bachelor në degën e historisë në Universitetin e Yales, ku më pastaj gjatë periudhës 1972-1975-ës vazhdoj studimet postdiplomike në shkollën e biznesit në Harvard duke marrur titullin MBA ( Master i Administrimit të Biznesit).

Pasi ngadhënjeu në zgjedhjet presidenciale në vitin 2000-ës kundër rivalit të tij demokrat Al Gore, George W. Bush më 20 janar të vitit 2001-ës filloj detyrën e tij në mandatin e parë si President, ku sërish më 2005-ës do të rizgjedhet prap në këtë post. Shikuar globalisht, gjatë kohës së tij në krye të Shtëpisë së Bardhë ndodhën ngjarje të rëndësishme në SHBA. 11 shtatori i vitit 2001-ës [39] shënon një kthesë të madhe historike të politikës amerikane në drejtim të Lindjes së Mesme. Lufta kundër terrorizmit ishte bërë një nga prioritetet kryesore të politikës amerikane ku si pasojë e kësaj erdhi deri te intervenimin amerikan në Afganistan dhe Irak. Këto luftëra u bënë ndër luftërat më të debatueshme të politikës së tij, çka ndikoj edhe në imazhin e tij në botë, ndryshe nga parardhësi i tij në luftën e Kosovës.

Ashtu si në rastin e Kosovës dhe të presidentit Bill Clinton i cili mori vendin e të parit në drejtim të idesë së bombardimit të Serbisë, lufta në Afganistan dhe sidomos intervenimi amerikan në Irak në politikën globale do të identifikohet me personalitetin e Georg W. Bush, si shkaktar kryesor i këtyre luftërave[40] çka dhe do të ndikoj poashtu edhe në popullaritetin e tij brenda populit amerikan, që pastaj edhe dë të ndikojë në zgjedhjet nacionale me humbjen e zgjedhjeve

[39] Një nga ngjarjet më prekëse ishte sulmi terrorist ndaj kullave binjake në qendrën tregtare botërore New York, ku përgjegjësinë për këtë sulm më vonë e morri ish udhëheqësi i Al Kaidas Osma Bin Laden. Kjo ngjarje ishte edhe një indicator për ndryshimin e politikave internacionale.

[40] Lufta në Irak kundër armëve të shkatërrimit në masë të cilat dyshohej se ishin në posedim të regjimit diktatorial Sadam Husein, nuk u gjetën asnjëher. Në shumë vende të botës pati edhe protesta, sidomos në vendet Islamike kundër politikës Amerikane. Por protestat kundër Georg W. Bush kishte poashtu edhe në Europ, ku gjatë vizitave të tij të bërë në këto vende pati protesta të ndryshme të qytetarëve duke shfaqur pakënaqësinë e tyre lidhur me politikën e tij.

të partisë republikane me një diferencë të theksuar në rezultat ndaj demokratëve të udhëhequr nga Barack Obama.[41]

Në mandatin e dytë presidencial të George W. Bush Kosova shpalli pavarësinë, e cila edhe është një nga ngjarjet më të rendësishme, e e cila e kishte përkrahjen e administrates shtetërore amerikane, është ajo çka e bënë të njohur të shqiptarët e Kosovës ish - presidentin amerikan Georg W. Bush. Si një nga ngjarjet më të rëndësishme e cila ndodhi gjatë kësaj kohe është padyshim shpallja e pavarsisë së Kosovës, ku roli i presidentit amerikanë është më i rëndësishmi në këtë proces.

## 3. Pse Clinton dhe Bush

Për të qartësuar edhe më tutje symimin tim për trajtimin e këtyre dy figurave, e rendësishme është edhe çartësimi I konfliktit shqiptaro-serb në ish Jugosllavi. Në pjesën e mëposhtme, duke iu referuar kryesisht literaturës, do të provoj të paraqes shkurtimisht konfliktin e lartëpëtmendur, ku edhe SHBA kishte një rol teket aktiv në përkrahje të të drejtave të njeriut që nga fillimi i viteve të 1990ta, përkatësisht që nga ndryshimet kushtetuese të ish federatës Jugosllave, ndryshime të cilat edhe shpien deri te shpërbërja e Jugosllavisë. Një rendësi të veçantë në këtë rast për mua, sidomos për sqarimin e shpërbërjes së Jugosllavisë ka libri i Holm Sundhausen "Jugoslawien und ihre Nachfolgestaaten"[42]. Për të u njohur me historinë e Kosovës edhe pse i botuar qysh në vitin 1998, një rendësi të posaçme ka libri i Noel Malcolm "Kosovo, a short history" i cili sçaron historinë e Kosovës por mjaft thellësisht përshkruan shpërnguljet e shqiptarëve nga vise të caktuara të Serbisë së sotme. Për lexuesin një histori e Kosovës e cila paraqet rendësinë e Kosovës për serbët dhe shqiptarët në njërën anë, dhe për dallim nga Malcolm dhe natyrisht duke patur parasyshë edhe faktin që është një libër më I ri. Trajton Kosovën deri në vitet e shpalljes së pavarësisë duke paraqitur edhe akterët kyq të historisë më të re të Kosovës, bombardimet e NATOS dhe adminsitratën e UNMIKUT .[43]

[41] Clarke Rountree: George W. Bush. A Biography. Green Wood Publishing Group, 2011 USA.
[42] Holm Sundhausen: Jugoslawien und seine Nachfolgestaaten 1943-2011. Eine ungewöhnliche Geschichte des Gewöhnlichen. Wien/Köln/Weimar: Böhlau 2012.
[43] Oliver Jens Schmitt: Kosovo. Kurze Geschichte einer zentralbalkanischen Landschaft.Wien/ Köln/ Weimar: Böhlau UTB 2008.

## 3.1. Përshkrim i shkurtër i konfliktit Shqiptaro-Serb dhe internacionalizimi i çështjes së Kosovës.

Shpërberja e Jugosllavisë në fillim të viteve 90-ta për popullin e Kosovës kishte disa karakteristika të veçanta si nga ana nacionale (ku kemi të bëjmë me një popull i cili për nga identiteti kombëtar është krejt i ndryshëm në raport me atë Serb)[44] poashtu edhe për nga fuqija e resurseve mbrojtëse të cilat i posedonte populli shqiptar i Kosovës në atë kohë. Gjersa në rastet e Sllovenisë, Kroacisë dhe Bosnës kemi të bëjmë me shtete të cilat në një mënyrë apo tjetër ishin më të organizuar në aspektin ushtarak falë pozitave të tyre kushtetuese të cilat i kishin në kuadër të federatës Jugosllave, Kosova nuk kishte trashëguar asnjë formacion të organizuar mbrojtës në këtë aspekt.[45] Me largimin e puntorëve shqiptarë nga institucionet arsimore, shëndetësore, sportive dhe kulturore nga puna,[46] shqiptarët e Kosovës filluan themelimin e institucioneve të tyre vetëqeverisëse duke filluar një rezistencë paqësore kundër pushtetit dhe aparatit Serb të instaluar në Kosovë.[47]Kësaj rezistence i priu kritiku letrarë Dr. Ibrahim Rugova, njëherit kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës parti e cila ishte themeluar në atë kohë.

Përveç organizimit të brendshëm, një nga prioritetet kryesore të udhëheqësisë së atëhershme ishte internacionalizimi i qështjes së Kosovës nëpër qendrat Europiane dhe Botërore, gjegjësisht politika në drejtim të kërkimit të mbështetjes nga vendet demokratike perëndimore për të krijuar shtet të pavarur sovran dhe demokratik. Duke marrur parasysh situatën e brendshme politike në Kosovë dhe raportin e fuqisë mbrojtëse në raport me shtetin Serb, shqiptarët e Kosovës edhe pse me një popullsi relativisht të re në moshë e cila mund të mobilizohej për luftë, ishin të hendikpuar për një gjë të tillë në munges të resurseve teknike mbrojtëse dhe të armëve, gjë që shtyri popullin shqiptarë i Kosovës dhe klasen politike të atëhershme të udhëhequr nga Lidhja Demokratike e Kosoves si të vetmen rrugë të çlirimit ta shihnin përmes mjeteve paqësore dhe internacionalizimit të qështjes së Kosovës për të siguruar mbështetje ndërkombëtare në kërkesat e tyre për të krijuar shtet të lirë dhe të pavarur. Përveç

---

[44] Këtu kemi parasysh konfliktin serbo-slloven, serbo-kroat apo serbo boshnjak ku egziston një ndasi mëse e kjart në aspektin religjioz, por të paktën dihet se nga aspekti gjuhësore (Sllavofoles) kanë një afërsi të konsiderushme në mes veti.

[45] Këtu duhet bërë një përjashtim sa i përket posedimit të armëve në munges të institucioneve mbrojtëse te shtetit, kemi armëmbajtës privat të cilët për nevoja të ndryshme apo edhe për shkak të traditave kombëtare kishte familje shqiptare të cilat e posedonin nga një armë të lehtë. Por me shpërthimin e luftës në Kroaci dhe Bosnje, policija Serbe kishte ndërrmarur akcione nëpër shumë familje Kosovare për kërkimin e armëve, çka edhe më shumë minimizoj mundësinë e fillimit të luftës çlirimtare kundër aparatit shtetëror Serb të instaluar në Kosovë.

[46] Krahas.: Oliver Jens Schmitt:

[47] Katrin Boeckh: Serbien/Montenegro. Geschichte und Gegenwart. Regensburg: Verlag Friedrich Pustet 2009. Regensburg Südosteuropa-Gesellschaft. F. 200.

arsyeve të cekura, klasa politike në Kosovë duke organizuar një sistem të pluralizmit politik filluan të formoheshin parti të ndryshme politike me organizim dhe programe demokratike, bëri që demokracia të jet një sllogan i rëndesishëm i tyre të paktën i fjalorit politik për të treguar një orientim të tyre perëndimor dhe miqësi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Edhe pse rezultatet e pritura nga politika paqësore në fillim të viteve 90-ta nuk u realizuan,[48] internacionalizimi i qështjes së Kosovës gjatë viteve 1997-99-ës tregoj rezultatin e vet por jo në kohën dhe mënyren e pritur nga Kosovarët.

Ishin pikërisht amerikanët ndër të parët në krye me ish-presidentit Clinton të cilët legjitimuan Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si faktor politik negociues pas fillimit të luftës së tyre guerile kundër forcave policore dhe ushtarake serbe në Kosovë. Prezenca e drejtpërdrejt e të deleguarve të qeverisë amerikane të udhëhequr nga ish - presidenti Clinton gjatë viteve të luftës 1998-1999 në mesin e popullsisë shqiptare në zonat e luftës dhe vënja e kontakteve të tyre me pjesetarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në atë kohë, padyshim se konsiderohej një e arritur e madhe dhe një besim të pa lëkundur amerikanë në Kosovë.

Pa prezencën e tyre në tryezat e bisedimeve me qeverinë e Serbisë dhe pa konsulltimin paraprak me të derguarit amerikanë nëpër takime të ndryshme ndërkombëtare, ishte e pamundur të bërit politikë nga pala shqiptare e të gjitha frakcioneve politike në atë kohë, gjë e cila ndodhë edhe në ditët e sodme. Ishte zyra amerikane në Kosovë e cila konsiderohej si një nga diplomacitë e para e cila angazhimin e saj e kishte realizuar pos të tjerash përmes prezencës direkte në lagjen Dragodan të Prishtinës.

Lufta në Kosovë ishte një luftë e cila është zhvilluar ndërmjet dy palëve të pabarabarta në aspektin e potencialeve ushtarake. Masakrat kundër popullates së pafajëshme civile në mesin e të cilëve gra, fëmijë të mitur dhe pleq ishin skena të cilat i mbushen faqet e shtypit botëror në atë kohë. Padyshim se një nga masakrat e cila vëri ë lëvizje të gjithë mekanizmin politiko-ushtarak perëndimor ishte masakra e Reçakut, e cila ndodhi më 15 janar të vitit 1999-ës në një fshat në afërsi të qytetit të Shtimës. Poashtu në këtë ngjarje roli i bashkësisë ndërkombëtare dhe në veçanti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës ishte i pazëvendësueshem duke reaguar dhe i parë në vendin e ngjarjes vetëm pak minuta pas masakres kufomat e viktimave nga ushtrija Serbe, përmes shefit të misionit civil ndërkombëtare të OSCE-së zotëri William Walker,[49] i cili

[48]Më shumë rreth dështimit të politikës paqësore, shih: Shkelzen Maliqi, dialog me Baton Haxhiun- Shembja e Jugosllavisë Kosova dhe rrëfime tjera, UET/PRESS, Tiranë 2011. F. 195

[49] Blerim Shala: Vitet e Kosoves 1998-1999. Prishtinë: Rilindja 2000. f.159-160.

në prani të gazetarëve dhe mediave i emocionuar shpreh opnionin e tij për këtë ngjarje duke e cilësuar si masakër. Dhe padyshim pas këtij reagimi vjen edhe te intervenimi ndërkombetarë i NATO-së në Kosovë, intervenim i cili rolin kryesore të dhënies së dritës së gjelbër për këtë aktë sërish vjenë nga SHBA-të ku para çdo intervenimi Amerikan fjalën përfundimtare e ka presidenti Bill Clinton duke iu drejtuar qytetarëve të vet[50] tregonte arsyet e intervenimit ushtarak, si të vetmen rrugë për të ndalur dhunën dhe terrorin Serb të ushtruar ndaj popullatës civile shqiptare në Kosovë.[51]

Për ata të cilët ishte folur shumë në media dhe cilësoheshin si shpëtimtarët e vetëm, tani pas përfundimit të luftës në Kosovë populli i Gjilanit kishte pasur fatin të ishte më afër me amerikanët, pasi që ky rajon ishte njëri nga sektorët e ndar të sigurisë ku ishin të vendosur ushtarët amerikan si përgjegjës për sigurinë në këtë rajon. Entuziazmi dhe admirimi i treguar për ta është shprehur në mënyra të ndryshme gjurmët e të cilit mund të gjinden edhe sot në jo vetëm në këtë pjesë të Kosovës, por edhe në qytete tjera si Prishtinë, Pejë, Mitrovicë, Ferizaj etj..

Edhe pse të çliruar nga pushtimi Serb në qershor të vitit 1999-ës, rrugëtimi i tyre drejt pavarësisë së plotë do të vazhdoj edhe për disa vite me pas. Meqenëse referendumi i vetëm i mbajtur pas fillimit të shpërbërjes së Jugosllavisë më 2 korrig 1990-ës nuk solli as edhe një njohje të vetëme të shtetit të Kosovës, klasa politike e pasluftës në Kosovë përgaditej prap për shpalljen e mëvetësisë së shtetit të Kosovës, por tani në kushte dhe rrethana të reja dhe duke siguruar mbështetje ndërkombëtare dhe posaçërisht me bekimin e SHBA-së.

Si një shtytje e madhe drejtë këtij proces padyshim konsiderohet vizita e presidentit Georg W. Bush bërë Shqiperisë ku deklaroj se " nëse gjatë këtij procesi arrihet në një pikë ku nuk do të arrihet marrëveshje (me Rusët), atëherë mund të thuhet se mjaft është mjaft dhe Kosova do të jetë e pavarur[52] ". Kjo deklarat e tij e bërë në Tiran vuri në lëvizje poashtu klasen politike në Kosovë për të shpallur pavaresinë e saj, gjë e cila ndodhi më 17 shkurt të vitit 2008-ës.

---

[50] Këto skena emocionuese të ish presidentit përmendën nga shumë të intervistuar.
[51] Marie-Janine Calic, f. 325-326.
[52] Citat nga : https://www.youtube.com/watch?v=983JknWcG0U , minuta 1:16 – 1.25, (e parë për herë të fundit më: 17.05.2015).

Në këtë mënyrë popullariteti i ish- presidentëve amerikan Bill Clinton dhe Georg W. Bush në Gjilan dhe Kosovë është i theksuar përkundër kritikave ndaj tyre të cilat në rrethana tjera të veprimit të tyre në vende të ndryshme mund ta kenë.

# 4. Imazhi i ish presidentëve në intervistat[53] e zhvilluara me qytetarë të komunës së Gjilanit

## 4.1. Atmosfera politike dhe gjendja sociale si faktorë ndikimi në imazh.

Kosova tani 10 vite pas çlirimit të saj është shtetë i pavararur që nga shkurti i vitit 2008-së. Tani (v. 2012-ës) sigurija në komunën e Gjilanit krahasuar me kohën e paraluftës, por edhe 2-3 vite pas përfundimit të saj[54] është një temë e cila nuk vihet në diskutim si problem në agjendat e organeve të sigurisë (KFOR dhe Policia e Kosovës) komunale gjë e cila ndikon në disponimin e shoqërisë për tema të ndryshme me karakter politik. Problemeve ndëretnike në Kosovë në kohën e pasluftës i kushtohej një rëndësi e veçantë nga organet e sigurisë, tani kemi të bëjmë me një komun e cila për nga shembulli i integrimit të minoriteteve mirret si model integrimi në mbarë teritorin e Kosovës dhe si pasojë e kësaj edhe këto probleme i takojnë të kaluarës.

Shikuar në aspektin social dhe ekonomik komuna e Gjilanit ballafaqohet me probleme të ndryshme në këto aspekte, probleme të cilat përcjellin mbarë Kosovën. Në të kaluaren e viteve 80-ës dhe 90-ës, komuna Gjilanit kishe të bënte me një industri dhe bujqësi intensvie të zhvilluar në këtë anë, ku gjatë pëeriudhës së industrializimit socialist ishin krijuar kombinate të ndryshme industriale në të cilat numri i punëtorëve arrinte mbi 1000 të punësuar në një ndërmarrje të atëherëshme shoqërore prodhimet e të cilave ishin të njohur në mbarë ish-Jugosllavinë e atëherëshme por edhe në Europë[55], ku dhe siguronin një mirëqenie relativisht të kënaqëshme qytetarët e punësuar të kësaj ane. Tani kjo industri është jofunksionale e cila gjatë

[53] Përgaditjes së punimit i kan paraprirë një sërë hulumtimesh të literatures nga fusha e metodikës së intervistimit dhe intepretimit. Mbi mënyren e parapërgaditjeve për intervistim, shtrimit të pyetjeve, zgjedhjen e personave për intervistime, sjelljeve me bashkëbiseduesit (të intervistuarit), kohën dhe vendin e intervistimit, sistemimin e materialeve dhe interpretimin e tyre, më tepër shih: Ulrike Froschauer/Manfred Lueger: Das qualitative Interview. Zur Praxis interpretativer Analyse sozialer Systeme. Wien: Copyright Facultas Verlags und Buchhandels AG facultas.wuv, 2003.

[54] Kur është fjala te siguria atëherë këtu kemi të bëjmë më shumë me incidentet ndëretnike të cilat kan qenë të theksuara në kohën e pasluftës, ku përgjegjës për sigurinë e Gjilanit ishte KFOR-i Amerikan në mungesë të themelimit të organeve vendëse policore në këtë shtet. Këtu duhet theksuar se incidentet etnike ishin të dy anëshme dhe se disa vite pas luftës në disa fshatra me shumicë Serbe në këto anë ishin të mbyllura për kalim për popullsinë shqiptare të kësaj ane.

[55] Këtu duhet cekur fabrikën e radiatorëve, baterive, atë të përpunimit të textilit etj.

periudhes 1990-1999-ës gjegjësisht kohës së okupimit Serbë gjithçka ishte shkatërruar nga këto ekonomi dhe në pamundësi për ti riaktivizuar prap këto ndërmarrje është bërë privatizimi i tyre, ku objektet e mbetura tani janë pronë sipërmarrësve privat shumica e të cilave punojnë tani si markete të ndryshme për shitjen e mallrave konsumuese në këtë komunë.

Të gjitha këto të cekura, kur kemi parasysh edhe natalitetin e popullsisë ku krahas punëtorëve të vjetër të cilët si pasojë e arsyeve të cekura më lartë nuk janë në marrdhënie pune, tani tregut të punëtorëve të papunë i janë shtuar edhe një pjesë e gjeneratës së të rinjëve të cilët poashtu janë në kërkim të një vendi punës dhe se në këtë mënyrë është një dëshpërim i përgjithshëm social i cili mbretëron në popullsinë e kësaj ane.

Problemet e ndryshme politike në raport me Serbinë bënë që shpesh herë qytetarët e Kosovës ti harrojnë këto probleme të ndryshme sociale dhe ekonomike, pasi që frika nga një agresion i mundshëm Serb dhe një ripushtim i Kosovës nga ta do të thoshte kthim prapa në luftën e vitit 1998-1999-ës, dhe për këtë arsye problemet politike dominojnë mbi ato sociale duke ndjerë frikën nga e kaluara. Dihet se që nga paslufta, Kosova dhe qytete të ndryshme vizitohen nga personalitete të ndërkombëtare të cilat për nga rëndësija janë vizita të ndryshme.[56] Këto vizita në të shumtën e rasteve mund të kenë karakter protokolar dhe shtëteror ku personalitete të ndryshme ndërkombëtare në cilësin e funksioneve të cilët ushtrojnë vizitojnë instutucionet e Kosovës apo edhe qeveritë komunale të saj. Por gjatë vizitës së personaliteteve të ndryshme ku e kaluara e tyre politike lidhet me ngjarje të rëndësishme në Kosovë, siç është rasti me ish-presidentët Cllinton dhe Bush,[57] kemi një mobilizim të veçantë si institucional poashtu edhe privat ku në qytetin e Gjilanit mund të shihen Bill Board të mëdhej të vendosur në vende frekuentuese të qytetit.

Një atmosferë e tillë mund të vërehet poashtu edhe në vendet rurale të cilët me vetëiniciativen e tyre në forma të ndryshme shfaqin admirimin e tyre për këto personalitete.

Të gjitha këto aspekte të cekura më lartë, si ai i politik, sigurisë, ekonomik, social, vizitat, janë gjëra të cilat padyshim së kanë ndikuar në imazhin amerikan në përgjithësi dhe në ish-

[56] Për shembull funksionar të ndryshëm të Bashkimit Europian, apo të shteteve të ndryshme Europiane, zyrtarë të shtetit Amerikan, zyrtarë botëror etj.
[57] Gjatë kohës së punës sime në tere në tetorë të vitit 2012, rruëve të Gjilanit mund të shiheshin fotografi të mëdha të Wesly Clark-ut dhe të sekretares Amerikane të shtetit Hillary Clinton.

presidentët në këtë rast për ti shprehur admirimet e tyre apo edhe ndoshta për ti fajësuar për gjendjen ekonomike e cila mbretëron në Kosovë.[58]

## 4.2. Zhvillimi i intervistave dhe vështirësitë

Përmes rekonstruimit të ngjarjeve të së kaluares qëllimi i intervistave është pasqyrimi i imazhit të ish- presidentëve në vitin 2012-ës.[59] Edhe pse në shikim të parë dukej si diqka e lehtë për mua, duke pasur parasysh përparësitë e cekura në kapitullin më lartë, puna në teren kishte vështirësitë e veta. Nga ana metodike isha përgaditur nga literatura të ndryshme profesionale të cilat më kanë shërbyer për të analizuar burimet e mbledhura. Një nga punimet të cilat më kanë përcjellur si model është edhe libri i Dieter Langewiesche "Zeitwende, Geschichtsdenken heute"[60] por për të rekonstruar mbamendjen e të intervistuarve bazë është marrë edhe libri i edituar nga Julia Obertreis dhe Anke Stefan "Erinnerungen nach der Wende". [61]

Përveç gjërave profesionale, nga ana praktike kam pasur ndihmën e kolegëve të ndryshëm të cilët më kanë ndihmuar për gjetjen e personave, biografija e të cilëve nuk përkon me ndonjë të kaluar apo të tashme të lidhur në ndonjë parti politike,[62] shtresë e cila me përjashtime të vogla nuk mund të cilësohej si objektive në vlerësimin e këtyre dy personaliteteve.

Marrë në përgjithësi, disa nga teoritë dhe metodat e punës të lexuara nga literatura mbi metodiken e analizës së intervistave dhe kulturës material, për arsye të ndryshme nuk iu janë përshtatur realitetit në teren, dhe për këtë arsye isha i detyruar të përdorë disa metoda të cilat

[58] Nga përvoja ime në të kaluaren duhet cekur se një nga problemet kryesore i cili ishte cilësuar si shkas për rënien e ekonomisë së kësaj treve ishte pushtuesi Serb. Për shkak të këtyre zhvillimeve ekonomiko-sociale, populli i Kosoves si të vetëmin shpëtim të daljes nga kjo krizë e papunësis dhe e krijimit të një perspektive më të mirë për ta e shihnin çlirimin nga okupimi Serb. Ashtu si gjatë intervistave nga shumë të intervistuarit, çlirimin e Kosovës ia dedikonin Amerikes dhe presidentit Bill Clinton. Për këtë arsye një nga pyetjet e mija direkte në shumicën e intervistave, e sidomos të atyre të cilët kishin një moshë më të pjekur ishte: Ç´ka Bill Cllinton Georg W. Bush? Përgjigja: Na kanë çliruar dhe na kanë pavarësuar. Pyetja: Por ku është tani ekonomija jonë, papunësija është e madhe?

[59] Krahas: Julia Obertreis / Anke Stephan (Hg). Erinnerungen nach der Wende. Oral history und (post)sozialistische Gesellschaften. Essen: Klartext-Verl. 2009. f. 53.

[60] Dieter Langewiesche: Zeitwende. Geschichtsdenken heute. Hg. von: Nikolaus Buschmann und Ute Planert. Göttingen: Vandenhoeck & Rupprecht Gmbh 2008.

[61] Këtu duhet pasur parasysh poashtu Master Seminarin të cilin e kam vizituar te profesor Oliver Jens Schmitt, ku kam vënë kontaktet e mija me disa studentë të cilët për nga metoda dhe mënyrat e hulumtimit të temave ishin të ngjajshme.

[62] Isha i detyruar paraprakisht të kam informata mbi të intervistuarit, pasi që më kan ndodhur disa raste të intervistav ku përkundër deklarimit të tyre se nuk janë pjesë e ndonjë partije politike, gjatë intervistimit kam vërejtur se personat në fjalë ishin pjesë aktive të politikes edhe pse jo në hierarki të larte, gjë të cilën e kam vërtetuar edhe më vonë.

më janë përshtatur më së miri sidomos me të intervistuarit duke pasur synimin e arritjes së një rezultati sa më të përafërt drejtë të së vërtetës shkencore.[63]

## 4.3. Përceptimi i jashtëm

Disponimi i njerzëve për të folur mbi Bill Clinton dhe Georg W. Bush ishte i një niveli të lartë dhe numri i atyre që dëshironin të intervistoheshin ishte në proporcion me planet e mija paraprake.[64] Meqenëse metodika e punës nuk kërkon nga të intervistuarit patjetër të japin të dhëna personale si emrin apo edhe mbiemrin e tij dhe një anonimitet i tyre i një bisede të zhvilluar nuk paraqiste pengesë për punën time, një gjë e tillë bëhej pa hezitim gati se nga të gjithë[65] ku ishin të gatshëm ti japin të gjitha të dhënat e tyre personale si emrin, mbiemrin, datëlindjen, profesionin etj.[66] Kishte poashtu edhe nga ata të cilët ishin të zënë në vendet e tyre të punës dhe me deshirën e tyre intervistat i kemi zhvilluar pas aranzhimit të një termini të përshtatshëm për ata.[67]

Karakteristikat e tilla tregonin imazhet e para që në fillim të punës sime në teren lidhur me figurat Cllinton dhe W. Bush. Pavarësisht problemeve të ndryshme sociale dhe ekonomike apo të priturat e tyre nga çlirimi dhe lirija e Kosovës, jo rrallë herë edhe me dëshpërimet e popullatës në raport me institucione të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore në raport me Kosoven, kur është në pyetje Bill Clinton, George W. Bush dhe amerikanët nuk hezitohej në këtë drejtim.

---

[63] Vështirësit e para erdhen nga ana metodike. Gjithëçka lidhur me intervistat funksiononte në mënyrë perfekte gjersa filloja fazen hyrëse të intervistave të para dhe prezentimit timë përmes kontaktit për intervisten, ende pa filluar marrjen përmes diktafonit. Ndërsa gjatë fillimit të intervistes dhe lëshimit në funksion diktafonit për të marrur intervisten ndodhte e kundërta, për shkak të emocioneve që i kaplonte. Emri „Intervistë“[63] tingëllonte gjithnjë si diçka mediale dhe publike e cila në mënyrë të fshehtë do të shfrytëzohej nga unë për ndonjë publikim medial dhe mënyra e të shprehurit të tyre përmes gjuhës së zakonshme do të përqeshej nga lexuesit. Për këtë arsye ashtu siç kam cekur më lartë për ti realizuar këto intervista më është dashur të gjejë metoda tjera për të ma lehtësuar punën time. Si pikënisje për të ndryshuar qasjen ndaj paragjykimeve të tyre në raport me konceptet metodike dhe shkencore ka qenë ndryshimi gjuhësor i termit intervistë. Si shkas i kësaj gjatë takimit të parë me njerzë gjithmonë ju kam kërkuar nëse do të kishin mundësi të më ndihmonin për të bërë një "Bisedë" lidhur me Imazhin e ish presidentëve Amerikan, ndryshim i cili më ka ndihmuar në punën time të mëtutjeshme si një ndryshim gjuhësor pa e ndërruar thelbin e hulumtimit.

[64] Këtu duhet bërë përjashtime teknike ku kishte persona të cilët për arsye kohe nuk ishin në gjendje të japin intervista.

[65] Si rast specifik ishte i një të riu i cili për shkak të angazhimit të tij në një parti politike si pjesë e komisionit për analiza politike kërkonte që biseda të zhvillohej në mënyrë anonime. Me të kuptuar angazhimin e tij në atë komision politik nuk e kam intervistuar fare.

[66] Për ta zbuluar arsyen kam provokuar disa nga të intervistuarit ku gjatë prezantimit tim në fillim të takimit me ata kam thënë se „jam duke e hulumtuar imazhin e liderëve tanë politik në Gjilan“. Disa nga ata nuk donin fare të pranonin që të japin një intervistë të tillë, të tjerët pranonin të bënin intervista por në kushte anonimiteti.

[67] Një ndihmes në këtë drejtim përveç temes interesante ishte poashtu emri i Universitetit të Wienes, duke pasur një reputacion të theksuar akademik i cili ishte i njohur për ta.

## 4.4. Ndikimi i moshës në krijimin e imazhit

Si pjesë e planit tim përgaditore ka qenë e paraparë përfshirja e moshave të ndryshme për të shikuar perceptimet e ndryshme që rrjedhin nga gjenerata të ndryshme. Një pjesë nga këta janë ata qytetarë të cilët gjatë kohës së qeverisjes së Presidentit Cllinton dhe W. Bush kanë përjetuar ngjarjet në moshën e tyre rinore, të cilët tani janë në një moshë më të pjekur për të dhënë vlerësimin e tyre për ngjarjet të cilat kan ndodhur në moshen e tyre rinore. Në anën tjetër poashtu për të balancuar strukturen moshore kam intervistuar edhe disa të rinjë mosha e të cilëve ishte më e re dhe kohën e qeverisjes së tyre e kanë përjetuar më tepër si fëmijë në moshë, ku njohuritë dhe interesi i tyre për politikë në atë kohë ishte i mangët.

Kjo qasje e imja ndaj gjeneratave të ndryshme reflektoj poashtu edhe gjatë zhvillimit të intervistave duke sjellë reflektime të ndryshme në imazh. Dy grupet e cekura karakterizoheshin për disa veçori të cilat i bënin që të dallonin në mes tyre si: për nga njohuritë, interesi për të biseduar lidhur me temen,[68] burimet e informacionit, por edhe për nga kritika.

Një karakteristikë e veçantë te të moshuarit zakonisht vërehej një gatishmëri më e lartë për të bashkëbiseduar për të kaluaren e ish- presidenteve rreth angazhimit të tyre në Kosovë dhe imazhit të tyre për ata dhe se kalimi i kohës ka krijuar poashtu nostalgji për momente të veçanta duke folur për miqtë dhe ndihmën Amerikane dhe se aktiviteti i tyre politik dhe privat i herë pas here në media përcillet në mënyrë permanente. Një gjë e kundërt ishte me gjeneratat e reja të moshës 20-25 vjeçare, ku përveç kohës së shkurtër të intervistave dhe mundit më të madh timin që përmes pyetjeve më të shumëta tentoja të nxjerrë sa më shumë që është e mundur, aty këtu vërehen poashtu informata gojore të treguara nga njerëz të ndryshëm gjegjësishtë ato indirekt të rrëfyera *„kështu më ka treguar Babi“*[69], *„kështu kam ni prej të tjerëve“etj.*[70]

Edhe pse disa nga intervistat ishin spontane, emocionet, kujtimet si dhe fantazitë e tyre nga disa të intervistuar gjatë rrëfimit të tyre për ish- presidentet të dëgjuara nga gojëdhënat apo edhe nga forume të ndryshme në internet përbënin një pjesë të konsiderueshme të imazhit të tyre. Poashtu këtu për nga emocionet prapë prinë gjenerata e të moshuarëve, atyre të cilët kohën e regjimit Serb e kanë përjetuar në gjendje më të rëndë nganjëher duke qenë edhe vet pjesë e përndjekjes nga ai pushtet.[71] Ndërsa të gjeneratat e reja edhe pse të vetëdijshëm për gjëra të

---

[68] Interesi për kohëzgjatjen e bisedes si pasojë e njohurive të mangëta.

[69] Siç është rasti me Egzon Hajdarin me profesion Kamerier i moshes 22 vjeçare.

[70] Nga bisedat e mija me ata poashtu kam vërejtur se politika në përgjithësi është një temë më pak atraktive në krahasim me temat e tjera si sporti, ekonomija etj.

[71] Pas zhvillimit të intervistave në bisedën time me disa nga të intervistuarit ata rrëfeheshin poashtu edhe për jetën e tyre personale në të kaluaren dhe përvojat e tyre me atë regjim, ku disa nga ata në forma të ndryshme kishin qenë të burgosur dhe të persekutuar nga ish regjimi i Milloshevicit.

ndryshme të cila kanë ndodhur në të kalurën të kjo shtresë ndryshonte mënyra e të shprehurit të tyre ku ishin më të përmbajtur sa i përket fjalorit të tyre emocional, me që tani ata ishin më tepër të brengosur me gjëra tjera të problemeve ditore dhe se inercioni politikë i së kaluarës nuk ishte i nivelit të njejtë me gjeneratat e tjera më të moshuara.

## 4.5. Teknikat e intervistimit

Vendet ku më së shumëti janë të frekuentuara me njerëz në qytetin e Gjilanit kanë qenë cak i intervistave të mija në teren. Si vendet më të frekuentuar me persona të moshës mbi 18 vjeçare të diktuara nga unë ishin tregjet (si ai i gjërave ushqimore dhe i veturave),[72] kafiteritë e ndryshme të cilat kryesisht frekuentohen nga njerëz të profesioneve të ndryshme apo edhe simpatizantë partive të politike.

Bisedat të cilat i kam zhvilluar që nga fillimi i temës dhe deri në mbarim kanë qenë të ndara sipas një plani të renditur kronologjik të cilat jo rrallë herë devijonin nga bashkëbiseduesit[73] për arsye të ndryshme.[74] Për arsye metodike dhe praktike lirija e të shprehurit te tyre ka qënë një prioritet i bisedav duke pasur gjithnjë të drejtë në mendimet e tyre. Si hyrje në temë zakonisht ka qënë synimi ime për ti pasur njohuritë e parat e tyre për temen time, duke ju shtruar pyetjen: Bill Clinton dhe Georg W. Bush i njiheni apo jo? Pasi fillohej biseda në këtë mënyrë ku bashkëbiseduesit ishin plotësisht të lirë të tregoninë njohurit e tyre lidhur me këto dy personalitete gjër në fund të kësaj pjese pa asnjë ndërhyrje. Pastaj pasonin pyetjet e mia të ndara në mënyrë kronologjike duke filluar me presidentin Bill Clinton, për të treguar njohurit e tyre për këtë personalitet dhe ndonjë ndërhyrje nga ana ime e rastit duke tentuar që të nxjerr sa me shumë informata që bëjnë të mundur lidhjen e politikës së tij në raport me Kosovën për të përfunduar me jeten e tyre private të pas perfundimit të mandatit të tij. Krejt në fund për të mbyllur biseden për Cill Clinton kanë qënë disa pyetje provokative te cilat i kam shtruar në përpjekje për të nxjerrur një mas kritike për këtë personalitet varesisht prej bisedes së zhvilluar.

Mënyrë e njëjtë e bisedes me të njejtin synim dhe pyetje të parashtruara është zhvilluar poashtu edhe ish-presidentin amerikan Georg W. Bush. Ajo qka në përgjithësi e ka karakterizuar bisedën lidhur me këtë personalitet dhe raportet e tij me Kosovën kujtimet e tyre kanë qënë më

[72] Pasi që jo ç´do kund në qytet mund të gjindet një frekuentim i tillë i gjeneratave madhore, për arsye se egzistojnë edhe vende të tjera të frekuentuara por mosha e njerzëve janë shumica të moshës shkollore dhe si pasojë nuk kanë qenë pjes ë planit timë intervistues.

[73] Për arsye të cekura më lartë në kapitullin 10.1 Zhvillimi i intervistave dhe vështirësit, më vonë kamë qenë i detyruar që të gjithë ti njohtojë se ka të bëjë me një bisedë, e jo ta quaj si intervistë për arsye të konfuzioneve dhe hamendjeve që krijoheshin duke menduar se me të vërtetë jamë një student apo gazetarë.

[74] Nganjëherë nga kujtesa për kohën e luftës apo edhe nga dëshira për të treguar diçka të re nga ajo kohë që ishte e panjohur për mua.

të pakëta në këtë drejtim dhe kur krahasojmë kohën e bisedës lidhur me këtë personalitet në raport me Bill Clinton ka qënë zakonisht më e shkurtë me disa përjashtime të vogëla edhe pse kujtimi për të duhej të ishte me i freskët krahasuar me Bill Clinton.

Natyrisht, një nga synimet e mia ishte poashtu që në fund të bisedës sime për Georg W. Bush, në mënyrë të drejtëpërdrejt jam përpjekur gjithnjë përmes pyetjeve të parashtruara të tërhjeki vëmendjen e masës kritike lidhur me luftërat në Irak dhe Afganistan dhe popullaritetin e tij në vende te ndryshme të Europes dhe në botë si tendenc për të nxjerrur ndikimin e këtaj politike në imazhin e tyre në bashkëbiseduesit e mi.

Dhe krejt për fund të bisedave të mia gjatë trajtimit të temës, ka qënë pyetja drejtuar bashkëbiseduesve lidhur me domethëniën e Amerikes dhe ish-presidentëve të cekur në përgjithësi,[75] ku disa nga bashkëbiseduesit shprehnin poashtu edhe glorifikimet apo deshirat e tyre për këto dy figura, karakteret e tyre dhe jo rrallherë duke i krahasuar ata me personalitete të rëndësishme Historike te Kombit Shqiptare.

# 5. Bill Clinton dhe imazhi i tij

## 5.1. “Clintoni është një lloj shqiptari”[76]

Pasi që Bill Clinton ishte paraardhës i Georg W. Bush dhe ngjarjet e lidhura me të janë më të hershme krahasuar me ish- presidentin W. Bush, në këtë mënyrë kronologjike poashtu janë zhvilluar bisedat gjithnjë duke filluar së pari me temën e Bill Clinton.

Gjithnjë duhet pasur parasysh gjatë fillimit të bisedës për këto personalitet për të mos përdorur shkurtesen e emrit Bill Clinton & Clinton, pasi që emri Clinton në kohën e zhvillimit te intervistave (v.2012-ës) koincidojke më shumë me Sekretaren e Shtetit Amerikan Hillary e cila për pak ditë do të vizitonte Kosovën për të inkurajuar palën e Kosovës për zhvillimin e dialogut me Serbinë. Kjo vizitë e saj aktualizohej përmes Bill Bordav të vendosur në anë të ndryshme të qytetit të Gjilanit dhe në rastin timë mund të më shërbente për devijim të bisedës.

Ashtu si kam cekur më lartë, të flasësh për amerikanët në Kosovë është një ndjenjë e veçantë dhe krahas klasës politike, secili gjatë fushatave elektorale përpiqetë të paraqesë veten përmes

[75] Kjo pyetje ka qenë më shumë e diktuar gjatë bisedave ku temat nga imazhi i dy ish presidentëve, devijonte në drejtim të Imazhit Amerikan.
[76] Intervista e zhvilluar me Fatos Latifaj 38 vjeçar ne tregun e veturave ne Gjilan më 18.10.2012 ekonomist.

formave të ndryshme[77] si një i besuar i amerikanve, një gjë e tillë vërehej në një formë tjetër poashtu edhe në mesin e të intervistuarve disa nga të cilët përpiqeshin të rrëfenin ngjarje sa më interesante[78] dhe duke u munduar nganjëherë që të jenë sa më inovativ në informacionet e tyre dhe se janë duke treguar diqka të re.[79]

Meqenëse Clinton nuk udhëheq tani me SHBA-të por vendi i tij zë një pjesë të rëndësishme dhe të pa krahasuar me personalitete të tjera ndërkombëtare në historinë më të re të Kosovës. *„Clinton, si njeri i cili ka bërë shumë në histori për popullin shqiptarë, sdi kush ma shumë se ai ka bo në historine tonë",*[80] shprehet një student në një kafene në Gjilan.
Si përpjekje për të treguar admirimin e tyre mbi këtë përsonalitet, gjithnjë përsonaliteti i tij ndërlidhej me luftën në Kosovë dhe mënyrën e të vepruarit të tij në atë kohë. Rrëfimi i tyre zakonisht bëhej duke treguar gjendjen e rëndë të popullit shqiptarë në Kosovë të krijuar në atë kohë si pasoj e pushtetit serb, nganjëherë edhe përvojat e tyre përsonale dhe vuatjet e tyre gjatë atij regjimi për të argumentuar nevojën e ndihmës nga jashtë dhe intervenimit të NATO-s në atë kohë. Poashtu, një rëndësi e veçantë e rrëfimit nga të intervistuarit[81] ju kushtohej kapaciteteve ushtarake dhe politike të shtetit Serb duke i konsideruar si të pa konkurent në këto fusha në Ballkan dhe Europ dhe se pa ndihmen amerikane do të ishte e pamundur të çliroheshim nga pushteti serb. Në anën tjetër tregohej situata e shqiptarëve në atë kohë dhe mundësitë dhe kapacitetet e tyre luftarake në një luftë eventuale kundër okupatorit serb. Të gjitha këto kapacitete të popullit i përshkruan një intervistues me fjalët në vijim: *„Jo ka një kallash, por ka tre kallasha për njeri me naj pas dhone Amerika neve, kurr nuk ishum çliru prej shkaut edhe 700 vjetë mos te ish kanë Bill Clintoni"*[82] është një mendim i një qytetari nga Gjilani i cili gjersa pastronte një vetur të klientit të tij njëkohësisht intervistohej nga unë në vendin e tij të punës.

Fërkimet ndërmjet ambasadorit amerikan në Kosovë dhe lidereve të ndryshëm politik për tema të ndryshme, ishin fokus i debateve si në aspektin medial poashtu edhe gjatë intervistave ku pasqyronin mendimet e tyre në këtë drejtim. Christofer Dell i cili gjatë viteve 2009-2013

---

[77] Si për shembull Foto të ndryshme të bërë me personalitete Amerikane si Bill Clinton, Madeline Albright etj.
[78] Kjo vërehej nga mënyra emocionale e të shprehurit të tyre.
[79] Mbase një gjë e tillë ndodhë sod përmes teknologjisë së zhvilluar informative dhe qasjes së mirë të popullates ne Internet. Mbi prejardhjen Shqiptare te Presidentit Clinton, shih: http://www.reagimi.com/amaneti-presidentit-amerikan-washington-per-shqiptaret-2/ (e parë për her të fundit më: 23.10.2015)

[80] Intervista me Ilaz Krasniqin 42 vjeçar, (student I gjuhës angleze) në një kafene në qendër të Gjilanit më daten 21.10.2012.
[81] Këtu duhet veçuar veçanërisht të moshuarit të cilët përveç informatave të zakonshme mbi shtetin Serb apo ish-Jugosllavinë, për nga ana Ushtarake kishin pasur mundësine të posedojne poashtu informata të dorës së parë, pasi që shumica e tyre kishin të kryer shërbimin ushtarak në ish Jugosllavi.
[82] Intervistë e zhvilluar me Agim Aliun, autolarës në lagjen Arbëria në Gjilan më 23.10.2012.

sherbeu si ambasador amerikan në Kosovë, kishte kritikuar disa herë parti të ndryshme politike në Kosovë për tema te caktuara duke sjellur ferkimet e hapura dhe të befasuara me një zyrëtar amerikan çka është e pazakontë në politiken shqiptare në përgjithësi. Shumë nga të intervistuarit ishin votues të po atyre liderve të kritikuar nga ai, por pavarësisht këtyre debateve imazhi për ish- presidentët amerikan dhe Amerikën në përgjithësi nuk ishte i ndikuar nga këto polemika dhe se e gjithë kritika vleresohej si një kritik miqësore dhe për qëllime pozitive.

## 5.2. „Na për jet, kurr nuk kishum mujt mu çliru pa ndihmen e Amerikës“ (v.1999-ës).[83]

Dhuna serbe në Kosovë e ushtruar nga aparati shtetëror serb, e intensifikuar sidomos gjatë luftës së viteve 1997-1999 -ës rritej me intensitet të shtuar. Edhe pse shqiptarët të organizuar në vetëmbrojtje përmes Ushtrise Çlirimtare të Kosovës (shënoj shkurt UÇK) një çlirim i vetëm përmes këtij formacioni ushtarak ishte thuajse i pa mundshëm ashtu edhe si do të ceket nga shumë intervistues. Arsenalin luftarak të cilët e posedonte ky formacion ushtarak në raport me formacionet ushtarake militare dhe paramilitare serbe në Kosovë vinte në pikëpyetje jo vetëm çlirimin e Kosovës, por edhe mbijetesen e popullit shqiptarë në Kosovë. Këto konstelacione mund të shihen poashtu përmes depërtimeve masive të popullsisë civile shqiptare, ku me se 1 milion shqiptarë të kosovës kanë qenë të detyruar të largoheshin nga Kosova dhe pa ndihmën e qeverisë amerikane gjatë presidences së Bill Clintonit ishte thuajse e pamundur që të ktheheshin prap në shtepitë e tyre.

Si pasojë e mbështetjes Ruse ndaj politikes Serbe në Kosovë dhe Ballkan, kemi një orientim të politikes shqiptare drejtë SHBA-së e cila udhëhiqej përmes udhëheqesit të shqiptareve të Kosovës Ibrahim Rugova.

Bisedimet e ndryshme të cilat kishin filluar ndërmjet palës shqiptare dhe asaj Serbe me ndërjmetesim ndërkombetar[84] për zgjidhjen paqësore të këtij konflikti nuk kishin dhënë asnjë rezultat të pritur. Populli dhe në veçanti udhëheqja politike e kohës e organizuar rreth Lidhjes Demokratike të Kosovës e udhëhequr nga Dr. Ibrahim Rugova, në munges të forces së vet ushtarake ishin të bindur se e vetemja mënyrë për të çliruar nga ky okupim ishte një ndihmë e cila do të vinte nga vendet e botës demokratike.

Duke marrur parasysh këto rrethana ndërkombëtare, si i vetëmi shpëtimtar i mundshëm për shqiptarët e Kosovës do të ishte Amerika tek i cili shtet i kishin shpresat që nga fillimi i viteve

[83] Bajram Salihu, 50 vjeçar me profesion mësues.

[84] Gjithnjë gjatë bisedimeve si një nga kushtet kryesore të pales shqiptare ishte pjesëmarrja amerikane në këto bisedime, pa të cilët pala shqiptare asnjëher nuk ishte e gatshme të bisedonte.

90-së  me fillimin e shpërbërjes së Jugosllavise. *"Vija e kuqe e Bushit të Vjeter kur ka ardh në Tiran në fillim te viteve 90-ës ja ka bo me dije Serbisë se nuk guxon ti prek shqiptarët."*[85] Politika e presidentit Clinton ndaj Kosovës nuk shihet si një pikënisje e politikes amerikane që nga koha e tij, por është një vazhdimësi e trasheguar nga paraardhësi i tij Georg Bush i Vjetër që nga koha e fillimit të shpërbërjes së Jugosllavise në fillim të viteve 90-ës, për të vazhduar më tutje.

Lufta për çlirimin e Kosovës e filluar nga popullata vendase (UÇK) zë një vend të rëndësishëm sa i përket meritave për çlirimin e Kosovës. Ky respekt për çlirimtarët tregohet në forma të ndryshme saqë rrëfime të ndryshme mund të degjohën kudo në Kosovë duke treguar për trimerit, heroizmat dhe mënyrën e të bërit të luftës nga ana e tyre. Përveq popullatës e cila shpreh admirimin e tyre për ta, përkujdesja insitucionale përmes emërimit të rrugëve,  shkollave etj, me emrat e ish- luftëtarëve shihet kudo nëpër qytete dhe fshatra. Është një pyetje e shpesht e cila prashtrohej në rrethe të ndryshme në shoqerinë shqiptare në Kosovë lidhur me meritat për çlirimin e Kosovës. Involvimi i faktorit ndërkombetarë respektivisht intervenimi i NATO-së në Kosovë shihet në mënyra të ndryshme sa i  përket meritave për çlirimin e vendit. Dhe këtu kemi pozicionime të ndryshme si të spektrit politikë vendorë poashtu  edhe të popullatës e cila në një mënyrë a tjetër influencohet nga këto pozicionime të klasës politike.

Gjersa për pasaredhësit e Ushtrise Çlirimtare të Kosovës meritat kryesore për çlirimin e vendit i atribojnë popullit shqiptarë te Kosovës të ndihmuar nga NATO, të cilet luftuan ose në një mënyrë a tjetër përkrahen Ushtrine Çlirimtare të Kosovës, ndërsa një mendim i kundërt është me mbështetësit e politikës paqësore të cilët meritat kryesore për çlirim i atribojnë ish-udhëhqesit të tyre Ibrahim Rugova i cili konsiderohej si një ndër më të besuarit e Amerikës dhe të Presidentit Bill Clinton.[86]

Kjo kontradikt grupore vërehet poashtu edhe në qytetin e Gjilanit e cila pas debateve të shumëta lidhur me përcaktimin e datës zyrtare të çlirimit të Gjilanit, LDK-ja e cila gjatë vitit 2002-së udhëhiqte me Gjilanin kishte vendosur që si datë e çlirimit të qytetit të ishte data 13 qershor, gjegjësisht data e hyrjes së forcave të Nato-së në Gjilan përkundër dëshires së opozitës së atëhershme të udhëhequr nga PDK-ja e cila si pasardhëse e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës insistonte që data e hyrjes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Gjilan me 15 qershor të jetë datë zyrtare e çlirimit të Gjilanit.

---

[85] Intervista e zhvilluar me Fatmir Devajen, 52 vjeçar në restorant Bujana në Gjilan..

[86] Më tepër synonime për Rugoven dhe Bill Clinton, poashtu në kapitullin e kultures materiale.

Gjithnjë kur jemi duke folur për Naton në mesin e popullsisë shqiptare në Kosovë, aty ceket roli dominanat i Shteteve të Bashkuara të Amerikes dhe të ish -presidentit amerikan Bill Clinton *„si një person kyç për intervenimin e NATO-së ndaj caqeve Serbe në Kosovë“.*[87]

## 5.3. Krijimi i mazhit përmes vizitave

*„Ka qenë shumë herë në vizitë në Kosovë, ka nejt me qytetare të thjesht, unë kam fotografi në shpi ku ka nejt edhe me katundar e femijë dhe ka qenë shumë i dashur“*[88] shprehet studenti 26 vjeçar i cili kishte dalur për të shitur një vetur në tregun e veturave në Gjilan. Këto imazhe janë krijuar nga vizitat e tij të ndryshme në Kosovë, si një njeri i afërt me qytetarët e saj dhe kanë mbetur një kujtes e bukur e së kaluares të vizitave të tij në Kosovë, madje duke qenë edhe fizikisht i pranishëm nëper familjet shqiptare përmes fotove të ndryshme të cilat ruajnë nëpër shtëpite e veta.

Poashtu, vizita e tij e bërë kampit të refugjatëve të ikurve shqiptarë gjatë vitit 1999-së në Maqedoni, ku një pjesë e intervistuesve poashtu ishin pjesë e këtyre refugjatëve në atë kohë kishte lënë mbresa të veqanta në mesin e tyre. Cllinton i cili në atë kohë kishte vizituar refugjatët shqiptarë, si president i SHBA-së poashtu kishte ecur në mes të turmes së njerzëve duke shetitur në masen e tubuar të fëmijëve fotografit të cilat ka lënë kujtime të pa harruara.[89]

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, në cilësin e presidentit ka vizituar kampin Amerikan Bondstell në Ferizaj. Puna e tij nga të gjithë intervistuesit kishte një rëndësi të madhe jetësore deri te egzistenca e tyre fizike, ku lufta në Kosovë ishte luftë për Jetë a Vdekje në sytë e të intervistuareve. Ndërsa modestija e punës së tij të bërë e shprehur në atë vizitë gjatë fjalimit të mbajtur para masës**:** *„Atë çka kam bërë unë për ju, është sa një pikë ujë në deti“*[90] bënë që ai të këtë poashtu një imazh të një personaliteti modest.

Vizitat e tij në Kosovë kanë shërbyer si besim të ndërsjelltë ndërmjet popullit të Kosovës dhe vet presidentit Cllinton. Vizita e tij bërë refugjatëve ka sjellur besimin duke treguar seriozietin[91]

---

[87] Intervist e zhvilluar me Gazmend Arifin 30 vjeçar, profesor i historis në ambientet e jashtëme të shkollës fillore Thimi Mitko në Gjilan më 24.10.2012.
[88] Intervist e zhvilluar ne tregun veturave në Gjilan me Shpetim Rexhepin më 28.10.2012.
[89] Më tepër lidhur me këto foto në kapitullin e kultures materiale.
[90] Bahri Uka 56 vjeçarë nga fshati Livoç i ulët komunes së Gjilanit, inspektor tatimor në Gjilan, si dhe ish i burgosur politik për shkak të pjesëmarrjes ne protestat studentore të vitit 1981.
[91] Është shumë me rëndësi serioziteti i kohës për shkak se që nga viti 1998-99 kishte përpjekje të ndryshme për të sulmuar serbin herë pas here nga fuqitë Europiane dhe Amerikane, por asnjë veprimë konkret nuk ishte bërë edhe pas shumë masakrave dhe dëbimeve të popullsisë nga pjesë të ndryshme të Kosovës. Kështu ishte krijuar nje atmosfer e mosbesimit në faktorin ndërkombëtar karshi qështjes së Kosovës.

e angazhimit amerikan në Kosovë dhe shpresën e tyre për tu kthyer sërish në atëdheun e tyre të çliruar.

Në anën tjeter vizita e tij pas përfundimit të luftës në Kosovë ka krijuar po të njëjtin besim të angazhimit amerikan të pasluftës tani në kushte te reja politike. Kurse tani në një fazë tjetër në atë të ndërtimit të një sigurie të qëndrueshme dhe arritjen e pavarësisë. Në kohën e zhvillimeve të rrethanave të reja ndërkombëtare ku problemi i Kosovës nuk është më në prioritet të politikës së jashtëme amerikane, vizita e ish-presidentit Clinton në Kosovë dhe këshillat e tij në drejtim të institucioneve të Kosovës dhe popullit të saj janë pranuar si këshilla të një miku. Në fakt vizitat e tij në përiudha të ndryshme kanë krijuar një bindje sigurie në mesin e popullsisë sidomos në kohen pas presidenciale te tij, duke krijuar nje bindje se Kosova është ende në fokusin amerikan dhe se përkujdesja e tij edhe në të ardhmen nuk do të mungoj.

### 5.3.1 Familja Clinton

*„Rrugën e tij, është duke e ndjekur tash gruja e tij Hillary Cllintoni, pse se nuk mundet me kanë ajo ndryshe kur ti je një njeri me ndjenja dhe unë isha kanë në gjendje për Cllintonin dhe familjën e tina isha kanë në gjendje me sakrifiku“.*[92] Është një përshtypje poashtu edhe për familjet e tyre e cila automatikisht krijohet për rrethin e saj, ku të intervistuarit njëherit shprehin admirimin e tyre dhe aktiviteti i të cilave po ashtu zgjon një kurreshtje ndër njerëz për të ditur më shumë për jetën e tyre private apo edhe karieren politike. *„Tash e kemi fatin që në krye të Amerikes është Hillary Cllinton si zyrtare Amerikane punon në të njëjten rrugë të shoqit të vet“*[93] dhe si pasojë e kësaj ka bartur një kontinuitet të politikes amerikane që nga koha e mëparme dhe se influenca e saj tani në qeverinë amerikane të udhëhequr nga Obama ka bërë të mundur që Amerika të mbaj kursin e njëjte politikë. Sipas kësaj është krijuar vetëdija e njerzëve dhe përshtypja se si Hillary Cllinton si grua e ish- Presidentit ka shtyrë politikat e Obama-s në drejtim të përkrahjes së Kosovës e cila mbështetje ka zënë fillin që nga koha e Bill Clinton.

Dhe se në atë qeveri amerikane ku udhëhiqet nga personalitete të cilet poashtu kanë qeverisur gjatë presidences Cllinton si dhe nga personalitet e tjera të cilët në një mënyrë apo tjetër kanë lidhje me ish-presidentin apo në rastin konkret me gruan e tij, aty krijohet bindja për një influencë direkte të tyre në politken amerikane në raport me Kosovën. Vizitat e saj në Kosovë kanë thuajse të njëjten rëndësi dhe besim të bashkëshortit të saj tani në një atmosfer të re politike ku interesimi amerikan për të shtyre procesin e bisedimeve me serbinë shihet si një garanci nga

[92] Po aty, Ilaz Krasniqi.
[93] Po aty, Gazmend Arifi.

pala kosovare, ashtu si kishte ndodhur me rastin bombardimeve të NATO –së kundër serbis me 1999-ës ku roli i presidentit Cllinton ishte vendimtar në këtë drejtim.

Për këtë arsye, ajo ishte shumë aktuale gjatë intervistave dhe në aspektin e kultures materiale foto të saj mund të shiheshin kudo në Gjilan të vendosura në vende të ndryshme në prag të vizitës së saj në Kosovë.

Tradita e familjeve në politikë është poashtu një shembull i njohur në Kosovë. Ashtu si me rastin e familjes Cllinton e cila konsiderohet si emblemë e çlirimit të kosovës nga pushtuesi serb, poashtu epitetin e njëjtë e gëzojnë shumë familje shqiptare nga rajone të ndryshme në Kosovë të cilat ndër dekada e shekuj kontribuan për lirinë e Kosovës.

## 5.4. Mishërimi i politikave të presidentëve me politikat e shtetit

Ashtu si kam cekur me lartë lidhur me kahjet e bisedës e cila nga imazhi i Bill Clinton merrte drejtim në imazh të amerikes duke shtjelluar më tepër temën e ndihmes së Amerikes dhe politikat e saj gjatë luftës në Kosovë, poashtu edhe sot 5 vjet pas shpalljes së pavarësisë Amerika shihet si një nga partneret kryesore të të gjitha zhvillimeve politike në vend jo vetëm nga populli kosovarë por edhe nga klasa dhe institucionet politike për të cilat Amerika është një nga partnerët strategjik të zhvillimeve në vend. Ndërsa sa i përket aspektit të siguris së jashtme posaqërisht me shtetin serb ku herë pas here egzistojnë probleme të ndryshme politike, posaqërisht duke mos njohur pavarësine e kosovës krijon tensione politike në pjesë të ndryshme të saj në përpjekje për të shtrirë prapë sovranitetin në këtë shtet, në këtë rast prap Amerika konsiderohet si mbrojtës i pa zëvendësueshëm pa të cilen është e pamundur zgjidhja e problemeve me këtë shtet. Në rast të një problemi me Serbinë *„me bo vaki me na ik Amerika neve prej këtu, skem qka me lyp me nejt na këtu asnjo mo, krejt mas tyne kena me shku na”.*[94]

Ngjarjet e zhvillimeve të politikes ndërkombëtare gjatë luftës në Kosovë ishin e një rëndësie të veçantë si një faktorë vendimmarrës për të krijuar mbështetje nga palët në konflikt. Politika e jashtme e bashkimit Europian në atë kohë nuk kishte një politikë unifikuese në raport me qështjen e Kosovës ku dominonin mendime të ndryshme të shteteve brenda këtij blloku kanë krijuar një dozë mosbesimi në atë kohë në mesin e qyetareve për qështje të ndjeshme politike. Hamendjet e ndryshme politike të shteteve të veçanta në fillim të konfliktit si ajo e *„Gjermanisë ku ish-ministri u punëve të jashtëme Joschka Fischer kishte deklaruar gjatë kohës së luftes se qështja e Kosovës është një qështje e brendshme e Serbisë“*[95] duke i lënë dorë të lirë politikes

[94] Po aty, Fatmir Devaja.
[95] Po aty, Bajram Salihu.

së serbisë ndaj kosovës krijoj një imazh negativ të qytetarët e cila i kishte bartur pasojat e veta në teren. Por në këtë rast prap vjen në pyetje autoriteti Bill Cllinton i cili ndërron mendjen e tyre sipas një të intervistuari. „ Fill pas vizites së tij në Amerikë dhe bisedes së tij me Clinton-in, Joschka Fischer ndërroj mendimin duke thënë së qështja e Kosovës është një qështje ndërkombëtare“. Në këtë mënyrë Clinton dhe administrata amerikane e udhëhequr nga ai konsiderohej si një qelës për të krijuar mbështejte të Europës dhe për senzibilizimin e opinionit ndërkombëtar në këtë drejtim.

Një nga arsyet kryesore të ndërlidhjes së luftës së Kosovës me personalitetin e tij është pozita e tij në adminsitraten amerikane si njeri i parë i shtetit i cili merr vendimet më të rëndësishme në politiken e jashtme amerikane. Ashtu si kam cekur më lartë, numri i personaliteteve amerikane të përmendur nga të intervistuarit është shumë i madh, madje një nga rrugët kryesore në qender të Gjilanit mban emrin e ish -sekretares amerikane të shtetit Madeline Albright e cila njihet për angazhimin e saj diplomatik gjatë luftës në Kosovë. *„Si William Wolker-in, Wesley Clarkun, krejt ata i ka udheheq Bill Clintoni se janë kanë nën administraten e tij“*[96] dhe për këtë arsye në popullin e Kosovës mbahet në mend si një ndër figurat kyqe të mbështetjes amerikane gjatë luftës në Kosovë.

*“Më meritori për bombardime ka qenë Clintoni se s’kanë dasht këta të hujt me bombardu, përveç Anglezve që i ka pas krah”*[97] është një përshkrim i aleatëve Amerikan gjatë luftës në Kosovë, dhe një neglizhenc e shteteve të ndryshme perëndimore ndaj luftës në atë kohë. Edhe pse angazhimi i diplomacisë ndërkombëtare në Kosovë e ka zanafillen e vet që nga fillimi i viteve të 90-ës me fillimin e shpërbërjes së Jugosllavisë, faktori ndërkombëtar deri në fillimin e luftës në Kosovë ishte më tepër i angazhuar në avancimin e lirisë dhe të drejtave të shqiptarëve të Kosovës në kuader të Jugosllavisë, ndërsa pavarësia e Kosovës si aspirat e këtij populli nuk vihej në diskutim. Gjersa pas përfundimit të luftës së bosnjës e cila përfundoj me qindëra mijëra viktima të vdekur, fillimi i luftës në Kosovë kishte të njëjtat zhvillime të luftës së bosnjës përmes keqtrajtimeve të civilëve, masakrave etj. Diplomatë perëndimorë të angazhuar për të gjetur zgjidhjen e këtij konflikti, nga përvoja e tyre në të kaluaren e ballkanit shpreheshin se nuk do të lejojnë që të përseritet Bosnja.

Fillimi i luftës në Kosovë përveç angazhimit diplomatëve për zgjidhjen paqësore të konfliktit, tani kemi poashtu edhe angazhimin e mekanizmave të siguris ndërkombëtare duke kërcënuar

[96] Po aty, Agim Aliu.
[97] Po aty.

serbinë me bombardime në rast se nuk do të ndal terrorin ndaj popullatës civile në Kosovë. Këto kërcënime ishin të një-pasnjëshme sa herë dëgjohej për ndonjë masaker. Madje, disa herë pas ultimatumeve përendimore të cilat përfundonin me ndonjë marrëveshje ndërmjet qeverisë beogradit dhe faktorit ndërkombëtar, asnjëherë nuk është arritur një paqe e qëndrueshme për shkak të mosrespektimit të tyre nga ana e beogradit. Mosrespektimi i këtyre marrëveshjeve dhe lëshimet e një- pas njëshme nga faktori ndërkombëtar duke mos ndëshkuar Serbinë, mundësoj në njëren anë rritjen e numrit të viktimave në Kosovë, ndërsa në anën tjetër krijoi një mosbesim ndaj faktorit ndërkombëtar për shkak të këtyre lëshimeve. Po ashtu edhe vet citati *„Më meritori për bombardime ka qenë Clintoni se s'kanë dasht këta të hujt me bombardu, perveç anglezve që i ka pas krah“* tregon anomalit e faktorit ndërkombëtar gjatë luftës në Kosovë, por edhe përkrahësit e pa rezervë të amerikanëve siq ishin dhe janë Anglezët. Këto dallime të faktorit ndërkombëtar kanë vazhduar edhe pas luftës në Kosovë gjerë në shpalljen e pavarësisë së saj, duke mos qenë të unifikuar në këtë proces. Dhe padyshim, konstatimi i të intervistuarit për rolin e Bill Clinton-it rrjedh nga vendosmëria e tij si president i Amerikes, i cili me autoritetin e tij kushtetues dhe atributin e tij moral urdhëroj bombardimin e Serbisë për të ndalur gjenocidin mbi popullaten civile shqiptare në Kosovë.

## 5.5 Prezenca e tij në kujtimet e familjeve

Intervistat nxjerrnin në pah shumë burime të informatave të cilat kanë ndikuar në imazhin e ish- presidentëve. Padyshim se burim kryesor i informacionit në kohën e sotme janë mediat elektronike dhe të shkruara, por edhe ambienti familjar poashtu është një ndër faktoret kryesor në këtë drejtim në të cilin bëhet emancipimi i brezave dhe gjeneratave. Një pjesë e rinisë e cila gjatë kohës së luftës në Kosovës ishin fëmijë të vegjël, kujtimet e mbetura nga lufta në Kosovë janë të pakta[98] megjithatë njohurit nuk mungojnë.

Ish- presidenti Cllinton i cili asocion me çlirimin e Kosovës është prezent në ç´do familje shqiptare në Kosovë, ku shpeshherë shpalosen kujtime rreth politikes amerikane në të kaluaren dhe roli i i heronjëve kombëtar i përcillet gjeneratave. Përmes intervistave të zhvilluara nuk ishte e vështire nga bashkëbiseduesit të nxirrej imazhi të ish-presidenteve ndër familjet e tyre, ku të rinjët gjithnjë mbështeteshin në burimin e informatave nga të tjeret.

*„Kshtu kam ni prej nanes, babes, vëllaznive krejt familjes temë për kohen e luftes dhe amerikant“*[99] me të cilët kanë shpalosur kujtimet e tyre në të kaluaren. Me këtë rast, intervistat e zhvilluara shërbenin poashtu si pasqyrë e imazhit të ish-presidenteve ndër familjet e tyre**,** *„ku*

[98] Më tepër shih lart kapitullin 4.4: ndikimi i moshes në krijimin e imazhit.
[99] Intervist e zhvilluar me Blerim Salihun në një kafene në Gjilan, rezervist i forces së sigurisë së Kosoves.

*përveç kujtimeve të së kaluares në shumë familje shqiptare gjenden simbole amerikane dhe foto te ish- presidenteve të cilat i ruajnë"*[100] si një kujtim i mirë i të së kaluares për ta.

## 5.6 Kritika e zbehur

Pavarësisht gjendjes politike dhe ekonomike apo edhe të arriturat jo të deshiruara në kosoven e pasluftes, por edhe orvatjeve të mija për të nxjerrur të pakten ndonjë kritik të vetme për ish-presidentin amerikan Bill Clinton, ishte pothuajse e pamundur të dëgjoje nje gjë të tillë. Varësisht prej moshës apo bindjeve politike dhe religjioze, të intervistuarit shfaqnin gjithnjë admirimin e tyre në forma të ndryshme. Vizitat e tij në Kosovë dhe pritja madhështore e cila është bërë nga qytetarët shqiptarë është dëshmija më e mire për imazhin e tij. *„Po të vjen ai edhe njëherë prapë në Kosovë, të gjithë dalum e presum i madh e i vogël".*[101] Ky imazh i tij në Kosovë është i pakrahasur me ndonjë personalitet tjetër ndërkombëtar apo edhe shqiptar dhe kalon masat e një ish-politikani dhe zë vendin e një heroi të gjallë duke u bërë i njohur në çdo familje në kujtimet e tyre për luftën në Kosovë për të zënë vend si një nga figurat e rendësishme dhe heronjët si Adem Jashari, Ibrahim Rugova vëllëzerit Haradinaj e shumë të tjerë.

*„Kur ka qenë Clintoni president ka qenë koha kur kemi ra me fjetë nuk e kemi ditë se a zgjohemi të gjallë në mengjes a jo"*[102]**,** gjatë kohës së luftës në Kosovë. Kështu përshkruhet periudha e luftës në Kosovë e cila pa një ndërhyrje ndërkombëtare ishte e pamundur që me forca të veta të largonte ushtrine serbe nga Kosova. Nuk mund të ketë një imazh tjetër pos të një çlirimtari i cili në momentet më të vështira bëri kthesë historike për të qenë i paharruar në mesin e qytetarëve të saj dhe *„se në zemrat e çdo shqiptari është si një personalitet, si një idhull i shqiptarëve dhe se atë nuk mund ta zëvendësoj askush".*[103]

Afera Lewinsky ishte e njohur për shumicen e të interevistuarve në mënyra të ndryshme, por ajo nuk e ka lëkundur aspak imazhin për ish-presidentin Clinton. Duke pasur parasysh respektimin e vlerave morale në shoqërinë shqiptare të Kosovës ku tradhëtia ndaj gruas është një imoralitet i madh shoqëror që ndikon direkt në personalitetin e individit, një gjë e tillë nuk ka ndodhur për Bill Clinton.

Poashtu edhe të intervistuarat e gjinisë femërore përkundër kësaj afere kanë një mendim pozitiv për të, ku *„Clinton duket shumë kavaler me kanë, dhe unë kisha pas qef me kanë ajo femra në*

[100] Intervista, Bahri Uka
[101] Intervista, Ilaz Krasniqi.
[102] Intervista me Bajram Salihun.
[103] Intervista me Gazmend Arifin.

*vendin e saj dhe pa hezitim nuk kisha nxitu për asnjë minut dhe asnjë shancë të vetme nuk e kisha leshu për të"*[104] **,** shprehet ajo.

Varësisht nga botëkuptimet sociale, morale dhe politike të të intervistuarve jamë munduar të gjej mënyra për të akuzuar të ish- presidentin amerikan gjatë kohës se tij si ish -president në angazhimin e tij në qeshtje të ndryshme botërore, por ishte thuajse e pamundur të nxirrej diqka në këtë drejtim për arsye të cekura me lartë dhe se imazhi pozitiv ishte i palëkundur.

[104] Anonymus 1. Intervist e zhvilluar me një vajzë 30 vjeçare në Gjilan studente e fakulltetit ekonomik.

# 6. Georg W. Bush dhe imazhi i tij në intervistat e zhvilluara në Gjilan

## 6.1. Bush dhe Kosova

Mandati i tij qeverisësh është mjaft i njohur për popullin shqiptarë në përgjithësi për angazhimi i tij direkt në drejtim të senzibilizimit ndërkombëtar të qështjes së kosovës dhe realizimit të premtimit tij të bërë gjatë vizites në Shqipëri për shpalljen e pavarësisë së kosovës. Pas fitimit të zgjedhjeve presidenciale nga ana e republikaneve në Amerikë, të pakët ishin zërat në Kosovë të cilët besonin në vazhdimin e mbështetjes amerikane pas humbjes së demokrateve dhe kandidatit të tyre John Kerry për të udhëhequr me Shtëpinë e Bardhe.[105] Bill Clinton përveç mishërimit të politikave të tij me politikat e shtetit, poashtu simbolizonte partinë demokrate personalitetet të së ciles ishin bërë të njohur për mbar opinionin kosovarë në atë kohë dhe një fitore e republikanëve shihej si me dyshim në drejtim të vazhdimit të politikave të partisë demokrate të Bill Cllinton-it.[106]

Mandati i parë 4 vjeçarë i presidentit Bush nuk përkon me ndonjë ndodhi të veçantë në raport me Kosovën. Përpjekje të vazhdueshme të lidershipit Kosovarë për të realizuar statusin final hasen në pengesa të ndryshme nga faktori ndërkombëtar i angazhuar në Kosovë përmes institucionit të quajtur UNMIK, duke vënë parakushte të ndryshme ndaj pales kosovare si "standarte para statusit", apo edhe argumente të tjera në raport me Serbinë njëherit duke pasur friken e ardhjes së forcave radikale në pushtet në rast të shpalljes së pavarësisë dhe se demokratizitmi i saj ishte i domosdoshëm para se të ndodhte një gjë e tillë.

Ndërsa kishte kaluar kohë që kur Kosova nuk ishte në agjenden e lartë të politikes së jashtme amerikane pasi që lufta në Afganistan dhe Irak kishte tërhequr vëmendjen e tyre, kjo politikë nganjëherë shihej me një dozë skepticizmi nga shqiptarët në Kosovë dhe se nostalgjija për demokratët e Clinton-it ishte e dukshme.

Mandati dytë presidencial solli në agjendë prapë kosovën në shtëpinë e bardhë. Përpjekjet e intensifikuara të lidershipit vendor për të shpallur pavarësinë e kosovës dhe për të siguruar njohje ndërkombëtare të saj i dha një shtytje e fortë vizita e Georg W. Bush në Shqipëri në qershor të vitit 2007-ës ku gjatë vizitës se tij në Tiranë deklaroi hapur mbështetjen amerikane për shpalljen e pavarësisë së kosovës. [107]

---

[105] Kundërkandidati John Kerry gjatë nominimit të tij për të garuar si president, kishte poashtu mbështetjen e lobit shqiptar në Amerik ku shihej si një i afërm i presidentit Cllinton dhe vazhdimit të politikave të tij si president.
[106] Madeline Albright, James Rubin, Wesly Clark etj.
[107] https://www.youtube.com/watch?v=6RHfcZhzV9c (e parë për herë të fundit më: 30.12.2015).

Momenti i deklarimit të tij në favor të shpalljes së pavarësisë konsiderohet si historik ku poashtu bëri një kthesë në vendet më me ndikim në botë për të dalur në muajt në vijim në mbështetje të saj.[108]

Imazhi i ish-presidentit Bush në botë kishte rënë në mënyrë të dukshme pas sulmeve në Afganistan dhe Irak imazhet e të cilit shpreheshin në mbarë botën përmes protestave të ndryshme, shkrimeve apo edhe karikaturave[109] duke e konsideruar si gënjeshtar të sulmeve të pa bazuara në Irak.

Ndërsa një ambientë tjetër i imazhit të tij, ndër të paktët në botë ishte në Shqipëri, Kosovë dhe ndër shqiptarët kudo që jetojnë i cili vazhdon të mbetet edhe sot. Skenat televizive botërore[110] paraqiteshin imazhe krejt të kundërta nga vizitat e tij në vende të ndryshme në Europ, ku gjatë vizites së tij në Shqipëri ishte një festë e madhe duke u mirëpritur nga turma të mëdha njërzish të mbledhur nëpër qytete.

Prezenca popullore ishte jo vetëm nga popullata e shqipërisë, por aty ishin prezent poashtu shqiptarë nga Kosova, Maqedonija dhe nga të gjitha trojet shqiptare.[111]

## 6.2 Bush dhe karakteri i tij diplomatik sipas të intervistarve

Gjersa për qytetarët e Gjilanit të moshes rinore Bush ishte më tepër i njohur për periudhën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe luftërave në Irak dhe Afganistan ku zakonisht biseda përqendrohej në këto dy tema, një tjetër karakteristik ishte për gjeneratat më të moshuara të cilët zanafillen e politikes së tij e gjenin që nga koha e babait të vet Georg Bush, apo Georg Bush i vjetër siç njihej në opinion. Madje ata përmes opinioneve të tyre ishin të mendimit se zanafilla e angazhimit amerikan në Kosovë dhe Shqipëri kishte filluar që nga Georg Bush i vjetër i cili në fillim të viteve të 90-ta me rastin e fillimit të shpërbërjes së jugosllavisë i kishte bërë të qartë "vijen e kuqe" serbisë për ti lënë shqiptarët të qetë në ballkan. Madje sipas tyre, qelësi i angazhimit amerikan në Kosovë vjen që nga ajo kohë për të vazhduar në mënyrë

---

[108] Shtetet si Franca dhe Nicola Sarkozy deklaruan mbështetjen e tyre, pastaj Britanija, Gjermanija, Turqija etj.

[109] http://www.google.de/imgres?imgurl=http://nadru0.files.wordpress.com/2012/03/george_w_bush_439195.jpg&imgrefurl=http://nadru0.wordpress.com/category/bericht/&h=400&w=303&sz=24&tbnid=XghP_JKpVXbXKM:&tbnh=92&tbnw=70&prev=/search%3Fq%3Dgeorg%2Bw%2BBush%2Bkarikatur%26tbm%3Disch%26tbo%3Du&zoom=1&q=georg+w+Bush+karikatur&usg=__PDvfkkfE3Y368cCZyVDbBGgisYU=&docid=bMwIVDAxARJUuM&hl=de&sa=X&ei=oQ10UehIlOfhBLDSgfgB&ved=0CDQQ9QEwAA&dur=2594 (e parë për her të fundit më: 20.05.2015)

[110] http://www.youtube.com/watch?v=K7W217GPqbc (e parë për her të fundit më: 23.06.2015)

[111] Video ku shihen shqiptarët e ardhur nga Kosova dhe Maqedonija gjatë vizites së Bush-it në Tiranë: http://www.youtube.com/watch?v=RyatmilKY3s (e parë për her të fundit më: 24.11.2015).

kontinuele te presidentët pasuses. Dhe aq më tepër, tani kur Georg W. Bush i riu ishte djalë ish- presidentit të vjetër Bush mendohej në mënyrë automatike për shkak të lidhjeve familjare në influencën direkte të cilën mund ta kishte nga babai i tij në mbështetje të shqiptarëve të kosovës për të realizuar shtetin e pavarur.

Ndërsa për gjeneratat e reja Georg Bush i vjeter ishte me pak i njohur dhe se Georg W. Bush njihej që nga vizita e tij e bërë Shqipërisë[112] dhe Kosovës[113]. Ishte më tepër një personalitet medial për qytetarët e Gjilanit për shkak të vizitave te pakëta në Kosovë dhe kontakteve jo direkte me masen qytetare, dhe më shumë i njohur përmes ngjarjeve ndërkombëtare dhe politikave të tij në lindjen e mesme.

Pritja e bërë nga qytetarët shqiptarë të mbledhur nga anë e kënd ballkanit në Shqipëri ishte e pritur, por deklarata e tij direkte pa ndonjë hapësir për intepretim tjetër nga mediat vendore dhe ndërkombëtare në mbështetje të pavarësis së kosovës ishte ndoshta e pa pritur nga populli shqiptar.

Vizita e tij në Tiranë ka dhënë hapësira të ndryshme interpretimi nga bota mediale. Këto interpretime ishin nga më të ndryshmet duke analizuar madje çdo detaj të vizitës së tij që nga mënyra e ecjes, përshëndetjeve e deri te spekulimi i mediave, sidomos i atyre serbe,[114] për vjedhjen e orës së dorës së tij gjatë përshëndetjeve të tij me qytetarët e shumtë që kishin dalur rrugëve për ta takuar atë. Madje pas vizitës kishte filluar njëfarë misticizimi i figures së presidentit amerikan *„Kam dëgjuar se Bush është anëtarë i familjës së Masuneve ku familja e tij ka një vend të rëndësishem në hierarkin e tyre duke zënë vendin e 4-të. dhe se kjo familje e kishin një princip kur po shkojshinë në vendëlindjet e tyre po i hjekshin kravatat sikurse bëri Bushi në Shqipëri.*[115] Dhe se për ta përforcuar këtë tezë të tijen, tani hynë në punë poashtu linguistika e gjuhes shqipe për tu krahasuar *„emri i tij Bush (në gjuhen angleze)-Bushat (në gjuhen shqipe) që është emer shqiptar të cilin e mbajn shumë njerëz”.*[116]

Arsyeja e angazhimit politikë të përsonaliteteve ndër popuj të ndryshme në histori shumë herë provohet të argumentohet në mënyra të ndryshme duke e justifikuar ndihmen e tyre me prejardhjen e tyre kombëtare. Tani kemi poashtu rastin me shumë personalitete të botës ku si shkas i angazhimit politikë të tyre në Kosovë arsyetohet me prejardhjen e tyre për ti paraqitur

[112] Vizita e bere gjate vitit 2007.
[113] Vizita e tij e bere Ushtareve Amerikan ne Bondstell pas perfundimit te luftes ne kosove me 2003.
[114] Albanci Busu ukrali sat. In: http://www.novosti.rs/vesti/planeta.299.html:199168-Albanci-Busu-ukrali-sat (e parë për herë të funti më: 27.12.2015)
[115] Intervista, Fatmir Devaja.
[116] Po aty.

si shqiptarë të emigruar që nga kohët e hershme në vende të ndryshme të botës[117] dhe se angazhimi i tyre politikë nuk është asgjë tjetër pos një borgj ndaj atëdheut të tyre dhe pa interesa politike. Siç është theksuar më lartë ngjashmëria e emrit Bush me emrin Bushat, një krahasim jo i veshtirë, tani një i intervistuar bënë një ndërlidhje tjetër ndërmjet Bush-it (amerikanve) dhe shqiptarëve në përgjithësi. *„Bushi dhe amerikanët në përgjithësi kanë karakter të njëjtë me shqiptarët për shkak të vendosmërise që kanë"*[118] shprehet një qytetarë nga Gjilani i cili si bashkëpronar në firmen e tij për riciklimin e mbeturinave të plastikes kishte një Amerikan.

Simpatija e këtij qytetari rrjedh më tepër nga fakti i pritjeve të gjata të politikës ndërkombëtare në periudha të ndryshme të konfliktit në Kosovë para fillimit të sulmeve ajërore të Nato-së ku politika ndërkombëtare ishte disa herë e pavendosur në këtë drejtim duke shtyrë afate të një-pas njëshme për bombardimin e Serbisë, e cila mbështetje vazhdon edhe pas përfundimit të luftës në Kosovë me shpalljen e pavarësisë së saj kur tani përkrahja ndërkombëtare është më se e nevojshme[119] për njohjen ndërkombëtare të shtetit të saj. Në rrethanat e reja politike të shqiptarëve në Ballkan si shteti kryesor tani vjen prapë në skenë SHBA-të nën udhëheqjen e presidentit Georg W. Bush, të cilët poashtu si gjatë vitit 1999-ës marrin rolin udhëheqës për të mbështetur shqiptarët në Shqipëri për anëtarësim në NATO dhe ata të Kosovës për realizimin e aspiratës se tyre shtetëformuese.

Ky imazh i një njeriu të vendosur rrjedh për faktin e mbajtjes së premtimit të dhënë gjatë vizites së tij në Shqipëri, i cili premtim në gjuhën e popullit njihet me termin" BESA" e cila tradicionalisht tek shqiptarët luan një rolë të rëndësishem për vlerësimin e karakterit të njerzëve në përgjithësi, i cili çmohet si një tipar i rëndësishem i kulturës kombëtare shqiptare.

Edhepse George W. Bush, i takon grupit të presidentëve që në karrierën e tij njihet si bartës i disa luftërave, ndër shqiptarët e Kosovës, duke dashur që të mos mohojnë edhe gatishmërinë e tij për një intervenim ushtarak në Kosovë në rast nevoje, arsyetohet me periudhën e diplomacies

[117] Në forume të ndryshme shqiptare në internet kemi arsyetimin e angazhimit te Bill Clinton-it në Kosovë kinse ka rënë në gjurmë të një dokumenti sipas të cilit Georg Washington të ketë qenë me prejardhje shqiptare dhe se angazhimi i tij është bërë për hirë të prejardhjes së themeluesit te SHBA-s. Më shumë shih: http://www.gazetatema.net/web/2011/04/01/george-washingtoni-me-prejardhje-shqiptare/ (e parë për herë të fundit më: 25.01.2013)

[118] Inervista me Fatos Latifaj. I njejti ishte këmbengulës ne bindjet e tij sidomos për karakterin e njejtë Amerikano-Shqiptarë për arsye të përvojes së tij ne biznes me një Amerikan, dhe vizitave te shpeshta të tij ne SHBA.

[119] Për arsye se shqiptarët në Kosovë edhe më heret që ne vitin 1991 kishin shpallur pavarësin, por munges të perkrahjes ndërkombetare kjo qështje nuk arriti të kishte legjitimitet ndërkombëtar.

në Kosovë, një kontribut të cilin e kishte dhënë Bush. *“Kur ka ardh Bushi, u kanë koha e diplomacisë ku ai ka reagu, su kanë kohë e luftës mo”*[120]

Georg W. Bush dhe vizita e tij në Shqipëri kishte hjekur dilemat e Kosovës që mbizotëronin ende në bashkësinë ndërkombëtare për shtetësinë e saj. Ashtu si në kohen e fillimit të luftës në Kosovë dhe dilemat rreth ndërhyrjes ushtarake ndëkombëtare për të ndalur spastrimin etnik. Pas përfundimit të luftës ishte fusha diplomatike e veprimit e cila mundësoi shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe njohjen ndërkombëtare të saj.

Shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ishte vetëm një qështje e brendshme e institucioneve vetëqeverisëse në Kosovë të cilat mund ta shpallnin pavarësinë e saj, por para se gjithash qështja e njohjes ndërkombëtare e këtij shteti ishte një nga problemet kryesore ku nevojitej një kordinim ndërkombëtar për të mos u përseritur 2 korriku i vitit 1990-ës ku deputetët e atëhershëm të kuvendit shpallen Kosovën si njësi të veçantë në kuadër të federatës së atëhershme Jugosllave, e cila kurr nuk morri njohje ndërkombëtare të saj.

Nëse krahasojmë politiken ndërkombëtare amerikane gjatë udhëheqjes së Bush-it e cila me tepër identifikohej me luftëra ndërkombëtare, në rastin e Kosovës nga të intervistuarit konsiderohej si një politikan paqësor i cili ishte një ndër promotoret kryesor të njohjës ndërkombëtare të shtetit të ri**.** *„Prej Tanzanis reagoj dhe tha se Kosova është shpallur e pavarur dhe ne do ta njofim, masanej e njohen krejt njo mas njo“* [121]**,** ishte një thënie e një të intervistuari i cili shpjegon rëndësin e fjalimit të tij disa orë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt 2008-ës duke pasuar me lëvizjet e shteteve të tjera te cilat filluan njohjen ndërkombëtare të saj.

Menjëher pas aktit solemn të shpalljes së pavarësisë nga parlamenti i Kosovës, vemendja e qytetarëve të saj ishte e drejtuar në drejtim të Georg W. Bush dhe reagimit të tij në emer të SHBA-së duke e ditur rëndësin e njohjes së pavarësisë nga ky shtet. Dhe padyshim *„kur ka thonë Bushi me njoftë pavarësinë e Kosovës, bash qatëherë kena fillu me festu na, se përndryshe kurr s‘kanë pas me na njoftë kërkush tjeter“*[122].

Tani pas njohjes së pavarësisë nga SHBA-të diplomacia amerikane gjatë presidences së Georg W. Bush ishte angazhuar në drejtim te sigurimit të sa më shumë njohjeve ndërkombëtare të saj,

---

[120] Intervista, Bajram Salihu.
[121] Intervista, Bahri Uka.
[122] Po aty.

ku kjo politik amerikane sipas shumicës së të intervistuareve vazhdon edhe sot të zhvillohet nga presidenti i tashëm Barack Obama.

Për më tepër, duke dashur që ai të ngritet si karakter, nuk hezitohet të përmendet edhe karakteri i tij prej kauboji por edhe vendosmëria e tij: *„Bushi njeri me i vendost, njeri ma kauboj si shqiptaret, ku përveç Kosovës edhe ndërhyrja në Afganistan është dasht me pas zemer për me marr ate vendim“*[123]

Ashtu siç është cekur nga një i intervistuar më lartë lidhje me prejardhjen shqiptare të familjes Bush[124], tani kjo hipotez mbështjellet me petkun kulturor duke e përshkruar për nga karakteri si një shqiptar i pa lëkundur kur merr vendime të mëdha**.** *"Edhe pse nuk e dojn nëpër vende të ndryshme të botës, besoj se e kanë gabimisht se ky ka dasht mi rrezu pushtetet absolute dhe doktatoriale dhe ta sjellin demokracin në këto vende"*[125] dhe se imazhi i krijuar nga ndërhyrjet në Irak dhe Afganistan ndër popuj të ndryshëm të Europes duhet pasur parasysh edhe anën tjetër pozitive**,** ku *„ Gjermanët duhet me qenë të kënaqur se tani nuk kanë frikë nga sulme të ndryshme teroriste“*[126] që mund ta destabilizonte sigurinë e qytetarëve të Europes.

Ndërhyjra amerikane në këto shtete justifikohet me sigurimin e paqes në këto vende duke përmbysur diktaturat e ngjajshme me atë të Millosheviqit disa vite më parë. *„Askush nuk e dinë ma mirë se na se çka është me jetu nën diktatur, këtë e kemi ndje me lëkur, për këtë arsye shumë nuk dinë me vlerësu politiken e Bushit në këto vende“*[127] ku për shkak të jetës së tyre nën udhëheqjen e qeverive demokratike, njohja me diktaturat është më tepër e natyrës indirekte duke mos e përjetuar atë.

Në këtë mënyrë të intervistuarit gjejnë ngjashmëri të regjimeve të ndryshme në botë me atë të Milloshevigit ku shumë nga të intervistuarit[128] njëkohësisht përkujtonin kohen e bombardimeve të NATO-së kunder caqeve Serbe në vitin 1999-së, ku njëri ndër zërat kritik të këtyre bombardimeve ishte poashtu ish-diktatori Sadam Husein nga Iraku i cili kishte kryer studimet ushtarake në Beograd.

Natyrisht, përderisa largimi i trupave serbe dhe ndalja e luftës në Kosovë nga popullata shqiptare mbahet në mend si meritë e Bill Clinton, pavarësia e Kosovës duket të jetë diçka për

---

[123] Intervista. Fatos Latifaj.
[124] Intervista, Fatmir Devaja.
[125] Intervista, Gazmend Arifi
[126] Intervista, Fatos Latifaj, reagim i tij pas pyetjes sime lidhur me protestat ne Gjermani gjatë vizites së tij në këtë shtet.
[127] Intervista, Bajram Salihu.
[128] Intervistat me Bahri Uken, Fatmir Devajen, Bajram Salihun, Ilaz Krasniqin.

çka meritën më të madhe në sytë e populates e gëzon pikërisht George W. Bush: *„Edhe pse s'mirrem qaq me politikë tybe sum intereson aq, por e di se mos ke Bushi, kurr s'ke tu ardh pavarësija"*[129] është mendimi i një të riu për të cilin pavarësia e Kosovës asocion në ish-presidentin Georg W. Bush. Edhe pse nga mosha e tij 6-7 vjeçarë gjatë kohës së luftës në Kosovë në vitin 1999-së, kujtimet e tij për luftën kryqëzoheshin ende në mendjen e tij gjatë intervistes, por zhvillimet e tashme politike ishin thuajse një temë tabu si e shumë të rinjëve tjerë e cila pak zgjonte kurreshtjen e tij. Gjithashtu periudha e pavarësisë së Kosovës ishte jo e largët për tu harruar dhe roli i ish- presidentit Bush vlerësohej si më i rëndësishmi në këtë periudhë.

## 6.3. „Veç të shqiptart ka ec pa trupëroje, se nuk u tut prej neve hiq"[130]

Gjithnjë fokusi kryesor i bisedave me të intervistuarit rreth imazhit të Georg W. Bush përqendrohej në interpretimin e vizites së tij në Shqiperi, si një vizitë me shumë ndodhi të veçanta të cilat kanë krijuar një imazh të ndryshëm politikë nga ai që mund të kishte në vende të ndryshme të Europes. Ashtu siq potencohet prejardhja e tij shqiptare nga disa të intervistuar[131] kjo tezë e tyre poashtu përforcohet edhe nga këndvështrime tjera të vizitës së tij në Shqipëri. Edhe pse jo të gjithë kishin pasur mundësin të jenë direkt të pranishëm gjatë vizitës së tij në Tiranë, kësaj vizite i'u është kushtuar një vëmendje e veçant poashtu nga mediat në Kosovë sekuencat filmike të të cilave kishin mbetur në mendjen e të intervistuarve.

Ashtu siq është në shumicen e rasteve të vizitave të qyteteve të ndryshme nga personalitetet qoftë vendore apo ndërkombëtare ku përcillen me masa të mëdha të siguris, e njëjta gjë ka ndodhur gjatë vizitës së ish- presidentit W. Bush në Shqipëri për shkak të prezencës së madhe të njerzëve të cilet kishin ardhur nga vendet e ndryshme për ta pritur atë. Por një befasi ndoshta e vetme e ndodhur nga vizitat e tij në vende të ndryshme të botës ishte kur Georg W. Bush në Shqipëri theu rregullat e sigurimit duke hyrë në mes të turmes që ti përshëndes qytetarët e shumtë me të cilet i shtrëngonte duart pasi që kishte hjekur pallton e tij.

Gjithë kjo atmosfer e pritjes, por edhe e sjelljeve të ish-presidentit përballë qytetareve të shumtë kishte ndërruar qasjen e mendimit të imazhit rreth presidentit i cili dukej si një presidentë i cili shkaktonte vetëm luftëra nëpër botë, dhe aq me tepër në raport me shqiptarët gjerë pak kohë para vizites së tij në Shqipëri vështirë mund të ishte parashikuar mesazhi i tij kryesor në

[129] Intervista me Fatmir Sylejmanin 21 vjeçar nga fshati Malishevë i Gjilanit, shkolla mesme ekonomike, i papunë.
[130] Intervista, Agim Aliu.
[131] Intervistat me Fatos Latifaj, Fatmir Devaja.

mbështetje të plotë të pavarësisë së Kosovës e cila për vite me radhë ishte heshtur nga politika ndërkombëtare.

Sjelljet e ish-presidentit mbase dukeshin edhe jo të zakonshme në mesin e turmës për një president amerikan, por ky qendrim i tij kishte krijuar përveç lidhjeve emocionale e cila ishte për personalitetet amerikane në përgjithësi në relacion me popullin shqiptar, tani me këtë rast ishte krijuar edhe një bindje praktike pas dëshpërimit të popullit shqiptar të Kosovës përballë politikës ndërkombëtare në përgjithësi i cili ishte krijuar përmes administrimit të Kosovës nga UNMIK-u (Unitet Nation Mision in Kosovo) duke mos u treguar e aftë në zgjidhjen e problemeve ditore dhe bërjen e shtetësisë së Kosovës.

Ashtu si në rastin e vizitës së ish-presidentit amerikan Cllinton bërë familjeve Kosovare të vendosur si refugjat në Maqedoni dhe premtimeve të tij për kthimin e të gjithë atyre në shtëpitë e veta, poashtu vizita e ish-presidentit Bush në Shqipëri kishte të njëjtën rëndësi, pasi që prania direkte e tyre në mesin e popullatës tregon seriozitetin më të madh në krahasim me deklaratat verbale të tyre nga Shtepia e Bardhë.

## 6.4. Kritika

Pjesë e interesimit tim ishte poashtu vlerësimi kritik i bashkëbiseduesve për ish-presidentin Bush.[132] Lufta në Irak dhe Afganistan  janë qështje për të cilat Georg W. Bush është kritikuar nga pjesa e madhe e botës duke krijuar një imazh tjetër nga ajo që është në Kosovë, madje nga qarqe të caktuara duke e etiketuar si nxitës të luftërave kanë bërë krahasimin e tij me ish-diktatorin gjerman Adolf Hitler[133].

Në një vend me shumicë muslimane ku mirret si shembull i bashkëjetesës së komuniteteve të ndryshme fetare dhe munges të konflikteve të këtij karakteri, kohëve të fundit fërkimet dhe etiketimet e ndryshme me prapavijë fetare kanë qenë një befasi nga disa Imam të ndryshëm të

---

[132] Gjithnjë gjatë përgaditjes së bisedes jam interesuar të mësoj më tepër për bindjet e tyre politike apo religjioze si parapërgaditje për pyetjet kritike që do të pasojnë. Për presidentin Bush në veçanti ishte i rëndësishëm fakti i mases kritike ndaj tij për politiken e bërë karshi vendeve me shumicë muslimane në lindjen e mesme, religjion te cilit i përkasin poashtu më së shumëti shqiptaret dhe rajoni i Gjilanit ne veçanti.

[133] Foto imazhit te tyre nje krahasim i bërë në një forum në internet: http://www.google.at/imgres?imgurl=http://www.history.ucsb.edu/faculty/marcuse/classes/33d/projects/media/BushHitlerShitAsshole.jpg&imgrefurl=http://www.history.ucsb.edu/faculty/marcuse/classes/33d/projects/media/AnalogiesUSPresHitlerMegan.htm&h=300&w=292&sz=47&tbnid=Dvs1Eg676kHeEM:&tbnh=90&tbnw=88&prev=/search%3Fq%3Dgeorg%2Bw.%2Bbush%2Bhitler%26tbm%3Disch%26tbo%3Du&zoom=1&q=georg+w.+bush+hitler&usg=__RN7brSJilRHHjbBrNxYslLzaDKI=&docid=vwV4TzQT_0kNEM&hl=de&sa=X&ei=Fi6GUbO8EMvRsgbmvYDgDw&ved=0CDEQ9QEwAA&dur=568 (e parë për herë të fundit më : 30.12.2015).

cilët etiketojnë personalitete të shquara të kombit të motivuar nga aspekti fetar.[134] Është një rastësi e rrallë ndoshta edhe e pa krahasuar me ndonjë të botës, ku interesat kombëtarë kalojnë interesat religjioze duke qenë gjithnjë të bashkuar në këtë drejtim. Tani edhe pse nga disa zëra luftërat në Irak dhe Afganistan mund të ketë prapavijë fetare, ndryshe mendojn të intervistuarit në Gjilan. Angazhimi amerikan iu ka sjellur të mira popujve dhe **se "** *duhet me qenë të kënaqur Irakianët se nuk jetojnë më nën diktaturë dhe një ditë e kam pa një dokumentar se si të rinjët Irakian për herë të parë kanë mundësine të zbaviten dhe të vallëzojnë me Rock Muzik, pasi nuk kanë guxu ma herët"*.**[135]**

Bush konsiderohet si një vazhdimësi e politikes amerikane në mënyrë të njëjte me rastin e Kosovës duke mposhtur diktaturat dhe çliruar popujt nga robërija. Madje *„dikush duhet të jet polic në botë"***[136]** si një forcë për ti rregulluar problemet e ndryshme dhe se këto veprime të tyre janë legjitime duke pasur parasysh gjendjen e tyre të pasluftës duke bërë krahasime të diktaturave të tyre me atë të Sllobodan Millosheviçit në Kosovë shprehet një i ri nga Gjilani. Qështja e Irakut e cila konsiderohet si një nga qështjet me delikate dhe kontraverse të intervenimit amerikan gjatë kohës së ish-presidentit Georg W. Bush për shqiptarët nuk është asgjë tjetër pos një përmbytje e një *„regjimi të udhëhequr nga një diktator i cili ishte shok i Millosheviqit, ku edhe shkollën ushtarake e kishte kryer në Serbi".*[137]

Edhe një arsye më tepër e cila e bënë më të popullarizuar Georg W. Bush-in ndër shqiptar në raport me politikën e tij në Irak ka një origjinë që nga koha e bombardimeve të NATO-së në ish- Jugosllavi në vitin 1999-ës, ku SHBA-at gjatë presidences së Clinton kishin ndërmarr operacionet sulmuese përkundër deklarimit të hapur kundër këtyre bombardimeve nga shtetet si Kina, Rusija dhe Iraku. Që në atë kohë Sadam Husein ishte njëri nga ata i cili ishte deklaruar hapur kundër bombardimeve të NATO-së ndaj caqeve ushtarake Serbe, përkundër faktit të marrur në aspektin religjioz bëhëj fjalë për vuajtje të një populli shqiptar me shumicë muslimane në Ballkan duke marrë parasysh se shumica e shqiptarëve në Kosovë i përkasin këtij komuniteti.

Për shkak të arsyeve të cekura më lartë dhe rrethanave të konflikteve në Irak dhe Afganistan krahasuar me Kosovën dhe rolin e Amerikes në çlirimin e saj, Georg W. Bush ka krijuar një

---

[134] Rasti i nënës Terezë nga imam Shefqet Krasniqi duke e etiketuar si prostitut.
[135] Intervista, Bajram Salihu.
[136] Intervista e zhvilluar me Edon Hajdarin 22 vjeçar në vendin e tij të punës si kamarier në një kafiteri në Gjilan.
[137] Ishte një mendim i njëjtë i shumë të intervistuareve të cilët kishin njohuri në këtë drejtim.

imazh të një çlirimtari në mesin e shumicës së popullsisë vendase në Kosovë, duke çliruar popujt nga tiranija dhe diktaturat e kohës.

## 7. Bill Clinton & Georg W. Bush – krahasime

Meqenëse qëllimi i intervistave ka qenë përfshirja e shtresave të ndryshme të cilët ndajnë përvojat të ndryshme në të kaluaren[138] dhe të tashmen e tyre, kjo ka bërë që poashtu të reflektoj në shprehje të ndryshme nga qytetarët e Gjilanit si në anën emocionale të tyre poashtu edhe atë të njohurive. Vizitat e tij kanë ndikuar për të krijuar imazhin e një personaliteti të afërt me qytetarët. Bill Clinton krijon një pasqyrë të një përsonaliteti modest i cili dinë të jet më emocional dhe i afërt me masën, i cili që në fillim është bërë i njohur që nga vizita e tij në kampin e refugjatëve në Maqedoni duke pasuar me vizitat e tjera në kosovë. Përkundër aferave të njohura për të intervistuarit siç është rasti me Monika Lewinsky dhe teorive të ndryshme dhe pretendimeve të mediave të caktuara ndërkombëtare sipas të cilave *„lufta e tij në Kosovë nuk ishte gjë tjetër pos për të mbuluar këtë afer“*[139]**,** imazhi i tij nuk është zbehur aspak në opinionin shqiptarë të Kosovës, madje një nga të intervistuarat e gjinisë së kundërt deklarohet duke thënë se *"ah çka kisha pas qef të isha në vendin e saj".*[140] Në këtë mënyrë politikat e tij në Kosovë kalojnë sekuencat "negative" të jetës së tij private, ngjashëm siç është rasti i Georg W. Bush dhe imazhi i tij në botë dhe në Kosovë.

Gerog W. Bush kujtohet më tepër në momente të veçanta për politiken ndërkombëtare dhe bisedat mbi këtë përsonalitet ishin më të shkurtëra në raport me Kosovën krahasuar me Bill Clinton-in për të cilin njohuritë ishin më të thella dhe biseda më tepër përqendrohej me Kosovën dhe veprimet e tij në momente të ndryshme në Kosovë. *„Bushi njeri ma i vendoset se Bill Clintoni“*[141] vlerësohet përgjithësisht politika e tij e veprimit në raport me Kosovën dhe me gjërë. Arsyet e këtij mendimi janë të ndryshme por parasegjithash vendimi për bombardimet e NATO-së gjegjësisht për shpalljen e pavarësisë së Kosovës për shkak të mosunifikimit të faktorit ndërkombëtar (SHBA dhe Britania në njerën anë, dhe shteteve të ndryshme Europiane

[138] Është poashtu me rëndësi e kaluara e tyre e cila vërehej gjatë intervistave të mija në njohuritë e tyre dhe mënyren e të shprehurit, pasi që disa si ish të burgosur politik gjatë kohes së regjimit Serb apo si mësues të cilët ishin ballafaquar me probleme të mëdha sociale dhe persekutime policore vërehej mënyra e shprehjes emocionale të tyre. Ndërsa me të rinjët të cilët për luftën në Kosovë njohurit e tyre ishin më tepër përmes gojëdhënave dhe mediave, vërehej një qetësi më e madhe ne biseda.

[139] Intervista, Edon Hajdari.

[140] Intervista me Anonymus 1, po aty.

[141] Intervista, Fatos Latifaj.

në anën tjetër) kishte bërë të mundur zgjatjen e marrjes së këtyre vendimeve pasojat politike të të cilave i përjetonin popullsia shqiptare e Kosovës pjesa dërmuese e së ciles ishte strehuar maleve të Kosovës dhe shteteve për rreth.

Gjersa vendimit të bombardimeve të NATO-së në Kosovë i kishin paraprirë një sërë ultimatumesh dhe lëshimeve të ndryshme që i'u ishin bërë Serbisë, vizita e presidentit Bush në Tiranë bëri të kjart qëndrimin e tij si president i cili rrallë herë, është dëgjuar të fliste në mënyrë direkte për pavarësinë e Kosovës. Mbase kjo deklarat e tij ishte edhe një befasi për shumicen e opinionit shqiptarë pasi që shpresat e realizimit të interesave të tyre kombëtare ishin më tepër të mbështetura në partinë demokrate të ish-presidentit Cllinton, i cili pas dy mandateve si president vendosi të mbështetestë guvernatotin John Kerry nga radhet e demokrateve si president i SHBA-së. Mbështetja e John Kerry-t nga ana e ish-presidentit Cllinton i cili për kunërkandidat kishe presidentin Georg W. Bush konsiderohej si rast i volitshëm në rast të fitores së demokratëve për vazhdimin e politikave të ish-presidentit Clinton në mbështetje të Kosovës. Kjo mbështetje për ish-senatorin John Kerry kaloi kufijt e mbështetjes morale duke u transformuar në mbështetje materiale nga ana e shqiptarëve të Amerikes, të cilët përmes mbledhjeve të fondeve materiale poashtu mbështetin liderin demokrat për president të SHBA-së.[142] Pas humbjes së demokrateve në këtë mandat dhe fitores së Georg W. Bush, mbështetja e tij për pavarësinë e Kosovës ishte një befasi për ta duke vepruar menjëherë pas vizites së tij në Shqipëri në mbështetje të shtetësis së Kosovës. Dhe me këtë aktë është forcuar bindja se pavarësisht ndërrimeve të mundshme politike në SHBA, gjegjësisht ndërrimeve të pushteteve, kursi i politikes së jashtëme Amerikane në raport me Kosovën nuk ndryshon dhe se mbështetja amerikane është në mënyrë permanente siç është cekur nga shumë të intervistuar.

Ajo çka i bënë të përbashkët në imazhin e tyre është angazhimi human i tyre në ndihmë të qeshtjes së Kosovës sipas të intervistuareve duke mos pasur ndonjë arsye tjetër të karakterit ekonomik apo interesit të veçant, si dhe duke u munduar të krijojnë lidhje gjeneanologjike me shqiptarët.

Përkrahja e tyre dhënë popullit shqiptar në Kosovë ishte ndihmë për arsye të forcave jo të barabarta në raport të paleve konfliktuoze dhe Amerika duke marr poashtu rolin e një "*Polici*

[142] Më tepër shih: http://m.zeriamerikes.com/a/a-30-a-2004-05-26-11-1-85588502/420032.html (e parë për herë të fundit më: 30.12.2015).

*për t'a ruajtur paqen në botë*"[143] është dashur të intervenoj për ti mbrojtur shqiptarët e Kosovës nga pushtuesi Serb duke marrur anën e më të dobëtit për ti ndihmuar për lirinë e tyre.

## 8. Kultura materiale

Kultura material poashtu zë një rol të rëndësishëm në studimin dhe imazhin e përsonaliteteve në përgjithësi. Ajo është e përhapur në forma të ndryshme dhe në frymen liberale të pa censuruar në Gjilan (Kosovë) ku njerëz të profesioneve të ndryshme si fotograf, artist etj, të cilët për qëllime biznesi, përmes veprimtarive të tyre mundohen të ofrojnë gjera sa më të bukura për klient dhe opinionin e gjerë. Poashtu është e përhapur edhe në forma jo profesionale ku amator të ndryshëm për motive përsonale mirren me fotografi dhe grafite të cilat i gjejmë nëpër mure të shkruara, pa ndonjë sistematizim të caktuar. Pas luftës në Kosovë me zhvillimin e teknologjisë kompjuterike kemi një zhvillim të ri në intensitet të kësaj lëmije ku përmes tyre krijohet një imazh mbi përsonalitete dhe ngjarje të caktuara politike dhe historike. Meqenëse tema ime përqendrohet në komunën e Gjilanit dhe fshatërave për rreth, si pjesë e punës sime ishte shëtitja nëpër teren në kërkim të fotografive, mbishkrimeve, simboleve të ndryshme dhe gjërave tjera që kanë të bëjnë me ish-presidentët amerikan.

Aty ku kam hasur grafite, fotografi apo gjurmë të ndryshme të kultures materiale me simbole amerikane, kam fotografuar dhe pyetur intervistuar kalimtarët e rastit për kohën e bërjes së tyre, si dhe motivin për ti bërë dhe ruajtur këto gjurmë të kultures materiale. Qëllimi i kësaj pjese të hulumtimit ishte të hulumtohej prezencën e kulturës materiale në këtë rajon dhe në qfarë mënyre[144] është i paraqitur imazhi i ish-presidenteve Amerikan përmes kulturës materiale, ku shumë fotografi apo grafite të tyre portretizojnë imazhe të tyre.

Krahasuar me intervistat hulumtimi i kulturës materiale ishte me i vështirë duke pasur parasysh sasine e tyre në kohën e hulumtimit. Poashtu një faktor më rëndësi ishte faktori kohë, ku krahasuar me kohën e kaluar gjegjësisht kohën e pasluftës në Kosovë ku fryma e lirisë dhe prezenca Amerikane në këtë rajon kishtë një kuptim tjetër, ku ushtarët e superfuqisë më të madhe në botë si dhe personalitete të ndryshme botërore me ndikim si Bill Clinton, Tony Blair, Wesly Clark[145] kishin mundësi ti shihnin vetëm përmes ekraneve televizive, tani prezencat e

[143] Intervista, Edon Hajdari.

[144] Mënyra e paraqitjes poashtu është një karakterisitik ne veti, ku gjejmë disa grafite apo foto të vendosura në vende të caktuara për të dhënë mesazhe me simbolika të ndryshme. Një shembull konkret, disa vende te frekuentuara nga Serbët për ti ngacmuar me heronjë të cilët kan luftuar kundër tyre.

[145] Si një dëshmitar i rastit kam qenë poashtu unë, ku disa javë pas luftes në Kosovë gjenerali Wesley Clark me eskorten e tijë duke kaluar në qendër të Gjilanit hap dritaren e vetures së tijë I cili rastësisht vërehet nga një

tyre të paralajmëruara në rrugët e Kosovës bënte që parapërgaditjet përmes formave të ndryshme për ti pritur në mënyrë sa më madheshtore në shenjë falemenderimi dhe respekti për ndihmen e dhënë gjatë luftës në Kosovë të jetë sa më e veçantë.

**Muralet - Thank You Clinton & Bush, God Bless Amerika**







*1.* *2.*

*Rruga në drejtim të Ptishtines me grafite dhe Foto (Foto Burimi Bislimi, Tetor 2012*-ës*)*

Ashtu siç e kam cekur më parë me rastin e çlirimit të Kosovës dhe hyrjes së forcave të NATO-së në Kosovë e cila nga qytetarët cilësohet si **„një mrekulli e zotit“[146],** ushtarët Amerikan të ardhur në Gjilan çdoherë janë pritur me buqeta lulesh dhe gëzime të papërshkrueshme.

Vlenë të veçohet një iniciativ spontane e të rinjëve gjilanas të cilet në mënyrë vullnetare ishin organizaur për të bërë një vepër të madhe artistike e cila pas një restaurimi vitë pas viti i ka qëndruar kohës deri në ditët e sotme. Këto vepra murale gjinden në hyrje të qytetit të Gjilanit nga drejtimi i rrugës për në Prishtinë, ku çdo njeri që niset për të udhëtuar në drejtim të Gjilanit në hyrje të qytetit ndeshet në këto grafite dhe piktura të bëra për nder të hyrjes së forcave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe atyre të NATO-së në Kosovë. Aty kemi lloje të ndryshme të simboleve dhe portreteve që datojn nga koha e pas luftës. Edhe pse jo të restauruara në 2-3

qytetar i rastit dhe vrapon i ngazënjyer në drejtim të vetures së tij duke bërtitur. Pas vetëm disa sekondave turma e njerzëve në drejtim të vetures së tij për të përshëndetur gjeneralin arriti një masë të papërshkruar.

[146] Intervista, Ilaz Krasniqi.

vitet e fundit gjegjësisht pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, por të ruajtura në mas nga qytetarët e kësaj lagje të Gjilanit, nga ajo që tani ka mbetur mund të dallohet një llojë rënditje e muraleve gjegjësisht flamujve dhe grafiteve të shteteve sipas rëndësisë dhe merites së tyre që kanë në opinionin e gjërë, gjë e cila është bërë poashtu edhe me përsonalitete dhe heronjë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ajo çka është për tu vërejtur në këto murale është mbizoterimi i simboleve dhe shkrimeve me përmbajtje Amerikane dhe të përsonaliteteve të tyre të cilat zënë një vend të rëndësishëm në këto murale. ***„Thank You Clinton & Bush“***[147] shkrimi qëndron në mesin e murit të lartë duke u renditur në anën e majtë dhe të djathtë të tyre përsonalitete të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. *„Kur kanë hi amerikanët i kena bo këto sene u kanë ndjenja e lirisë dhe nuk kena kursy asgjë në këtë drejtim“*[148] shprehet një plak i cili punonte si zejtar në afërsi të muraleve që nga periudha e para luftës**.** *„Tash na kaë rroke tjera gajle papunësija e madhe, hallet dhe dertet tona.“*[149] Sigurija nuk është një temë e cila cenon lirinë e individit në këtë regjion të Kosovës siç ka qenë në të kaluarën, dhe se tani ndjehet nevoja e të jetuarit dhe të sigurimit të një mirëqenie sociale të secilit individ për familjen e tij dhe se këtu shihet orientimi i popullit tani i interesuar më tepër me ngjarje të fushave sociale dhe ekonomike, ku për këtë problem nuk është në pyetje tani Bill Clinton, Georg W. Bush apo Amerika por qeverija e Kosovës e cila shifet si kompetent për problemet në fjalë.

Kjo vepër është bërë menjëherë pas përfundimit të luftës në Kosovë me rastin e hyrjes së forcave të NATO-së në Gjilan, gjegjësisht forcave Amerikane ku si zonë përgjegjëse e sigurisë së tyre ishte Gjilani. Në vitin 1999-ës fillimisht një grup i të rinjëve amator gjilanas në hyrje të qytetit kishin filluar të bënin vizatime të thjeshta në formë të grafiteve me simbole dhe shkrime të ndryshme si shenjë falenderimi për aleatet Amerikan.

Posa e kanë verejtur këtë iniciativ të këtyre të rinjëve të cilët me mjete shumë të thjeshta kishin filluar diqka të bënin në këtë drejtim, atyre i‘u janë bashkangjitur një grup i të rinjëve profesionist të artit vizatimor nga Gjilani të cilët poashtu edhe në munges të mjeteve të duhura në atë kohë për shkak të dëmeve të konsiderushme materiale dhe mungesës së veglave,

[147] Shih foto nr.1.
[148]Citat i intervistes me Sejdi Brahimin 65 vjeçar, zejtar i cili punon për më shumë se 20 vite në një lokal në afërsi të këtyre muraleve. Njëherit ishte ai cili kishte informatat më të mira për keto murale për shkak të biznesit të tij aty afër që posedonte.
[149] Po aty.

megjithatë kishin arritut për një periudh të shkurtër të bënin një vepër të madhe artistike e cila kishte zgjuar kurreshtjen poashtu edhe të mediave ndërkombëtare në atë kohe.[150] „

*Çdo vetur e cila kalonte aty pari dhe na shikojke se çka ne po bënin, ndalej dhe na urojke për iniciativen tonë dhe në mesin e tyre kishte shumë njerzë të cilët gjatë kalimit të kësaj rruge me veturat e tyre hapnin dritaret dha na ipshin para, pije dhe gjëra të ndryshme për të na ndihmuar me mjetet tona të nevojshme“*.[151] Duke pasur parasysh vendndodhjen e këtyre në hyrje të qytetit si mesazh i kjart për çdo vizitorë, këto pamje krijojnë një mesazh falenderues për miqtë e Kosovës dhe heronjëve të lirisë, gjegjsishtë të atyre që kontribuan për lirinë e Kosovës. Ndërsa nëse marrim një analiz të brendshme për të studiuar pikturat murale dhe grafitet të cilat gjenden, padyshim se më e theksuara është ajo e ish -presidentit Amerikan Bill Clinton dhe falenderimi për të.

